



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Edmond Spaho, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi dhe Pjerin Ndreu

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Reme Lala, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ani Dyrmishi - Administrator në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bashkim Kasoraho - Njësia e Zbatimit të Projektit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Luljeta Dauti – përfaqësuese e Sektorit Arsimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ermir Omari - projekt menaxher i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Sot në rend të ditës së punës së këtij komisioni janë tri çështje. I pari është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”, i dyti, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor” dhe i treti, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Për t’i prezantuar këto projektligje kemi ftuar zotin Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë dhe zonjën Dajna Sorensen zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë. Shoh që është lajmëruar edhe zoti zëvendësministër i Transportit.

Nuk ka ardhur? Atëherë lajmërojeni që, kur t’i vijë radha për të folur, të jetë në sallë!

Fillojmë me çështjen e parë, pra me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

Relatore e komisionit për këtë projektligj është zonja Evis Kushi.

Urdhëroni!

Jorida Tabaku – Në fakt, kryetar ne do të dëgjojmë marrëveshjet dhe do të shprehim mendimet tona në lidhje me to, por, duke qenë se kjo është mbledhja e fundit e Komisionit të Ekonomisë për këtë sesion, dua të ngre një shqetësim. Fatmirësisht qeveria i thirri mendjes dhe njoftoi datën 23 korrik si ditën e fundit të këtij sesioni parlamentar. Ajo nuk po tenton më të presë dhe të sjellë dekretin e Presidentit për ligjin e Teatrit dhe dua ta përdor këtë mbledhje të fundit të komisionit për t’i bërë edhe një herë thirrje qeverisë që, gjatë muajit gusht t’i thërrasë mendjes, të qetësohet dhe në shtator, kur fillon sesioni i ri parlamentar, të tërheqë ligjin e Teatrit dhe të fillojmë një diskutim konstruktiv në lidhje me një procedurë dhe një

tender ndërkombëtar të hapur për këtë çështje, duke përfshirë artistët, qytetarët dhe të gjithë zërat që kanë qenë kundër këtij projekti.

Kështu që edhe një herë ua përsëris kolegëve të mi socialistë të ndikojnë, aq sa kanë mundësi, në tërheqje e këtij ligji për të pasur diskutime serioze dhe konkrete për këtë çështje.

Meqenëse këtu kemi zëvendësministrin e Financave, se më pas do të vazhdojmë me marrëveshjen, i kam kërkuar zyrtarisht Ministrisë së Financave, por edhe kryetarin e komisionit e kam njoftuar, për të dhënat në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për 6-mujorin e parë të vitit. Nuk kanë ardhur akoma që javën e kaluar, megjithëse ishte detyrim ligjor të vinin dhe të publikoheshin. Sot është e mërkurë dhe bëhet pothuajse një javë që e kam kërkuar këtë gjë.

Unë e kuptoj që situata me të ardhurat nuk është nga më të mirat, e kuptoj edhe që qeveria nuk do të publikojë shpenzimet e as investimet publike, që, në fakt, janë turpi më i madh që ka ndodhur të paktën në këta 5 vjet, se nuk po them në 27 vjet. Si institucion, ju keni detyrimin të na vini në dispozicion të dhënat, meqenëse kryetari herë pas here më pyet pse nuk e bën zyrtarisht kërkesën nëpërmjet këtij komisioni. Kësaj herë e bëra zyrtarisht nëpërmjet këtij komisioni dhe prapë, pas një jave, nuk kam një përgjigje.

Së dyti, zoti Luçi, unë mund t'jua them edhe nesër në seancë, por po jua them sot meqenëse kemi mbledhjen e komisionit. Dje pashë në kalendarin e paraqitur për ditën e enjte se marrëveshja e TAP-it është riparë, duke propozuar një regjim të ri fiskal për TVSH-në. Kjo marrëveshje nuk ka ardhur në këtë komision dhe nuk mund të kalojë nesër në parlament. Çdo politikë fiskale, çdo rregull i ri, çdo regjim i ri diskutohet në këtë komision. Unë e kuptoj që Ministria e Financave ka frikë të përballët ashtu siç nuk u përball me ligjin "Për tatimin e fitimit", kur gënjeu në relacion për ligjin e lojërave të fatit dhe për ndryshimet përkatëse. Pra, ka frikë të vijë këtu e të përballët me këtë komision dhe me deputetët e tij.

Të jeni i sigurt se çdo ndryshim për marrëveshjen e TAP-it do të mbështetet nga ne, kështu që ju kërkoj t'i thoni titullarit tuaj të vijë e ta diskutojë këtu këtë marrëveshje. Unë do ta ngre edhe nesër në seancë.

Ne do ta mbështesim, por nuk mundet që qeveria shqiptare, e cila ka krijuar një amulli të plotë me sistemin e taksave, të kalojë ndryshimin e një takse pa e sjellë në këtë komision. E bëj këtë kërkesë edhe për ju, zoti kryetar, e kërkoja për ligjin e Teatrit, po e kërkoj tani edhe për marrëveshjen për TAP-in. Nuk ka asgjë të keqe që gjërat të vijnë në komision dhe të diskutohen, përkundrazi i sjell vetëm dobi procesit.

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Tabaku!

Zoti Luçi, kam një pyetje para se të fillojmë me marrëveshjen. Pse nuk publikohet fiskalja e 6-mujorit?

Erjon Luçi – Janë thjesht vonesat e zakonshme, por do ta ndjek menjëherë.

Erion Braçe – Unë kam parë ministrin këtu e dhjetë ditë para që e ka bërë publike këtë gjë në televizor.

Erjon Luçi – Janë thjesht vonesa.

Erion Braçe – Qenkan thjesht vonesa?! Atëherë deri në përfundim të orarit zyrtar nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë duhet të marrë fiskalen në dorë, në letër të printuar apo në formë elektronike qoftë.

Erjon Luçi – Do ta marrë.

Erion Braçe – Zonja Tabaku, vëzhgimi juaj është plotësisht i drejtë për çështjen e marrëveshjes mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si qeveri pritëse dhe *Consortium*-it TAP. Unë kam kërkuar sqarime pse Komisioni i Ekonomisë, që për mua është komision përgjegjës për shqyrtimin e kësaj marrëveshjeje dhe jo për dhënie mendimi, nuk është përfshirë. Sqarimet që kam marrë janë të pamjaftueshme si argument. Me sa duhet askush nuk e ka parë dhe e kanë konsideruar si veprimtari prodhuese çështjen e regjimit të ri fiskal që do të aplikohet në vijim për kompaninë TAP.

Ju keni plotësisht të drejtë dhe nuk kam asnjë gjë për të shtuar për këtë pikë dhe unë çfarë kisha mundësi e kam bërë.

Kush do ta prezantojë marrëveshjen?

Po, urdhëroni.

Dajna Sorensen – Përshëndetje, zoti kryetar,

Përshëndetje të nderuar deputetë,

Projektligji në fjalë ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes financiare mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A. Bëhet fjalë për programin e arsimit dhe formimit profesional, si dhe për marrjen e një huaje të butë në vlerën e 5 milionë eurove. Kjo marrëveshje vjen në vazhdim të marrëveshjes qeveritare dypalëshe për programin në fjalë dhe është miratuar në vitin 2017 me ligjin nr. 51 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për këtë program”. Në vetvete programi përmbush të gjithë vizionin e strategjisë kombëtare për punësim dhe aftësi për të siguruar aftësi më të larta dhe më të mira për të gjithë qytetarët.

Për sa u përket rezultateve të pritshme, unë do të nënvijëzoja që i pari ka të bëjë me organizimin dhe ngritjen e qendrës shumëfunksionale bujqësore në qarkun e Fierit, si dhe

përmirësimin e organizimit e Shkollës Mekanike të Lushnjës, kurse elementi i dytë ka të bëjë me rishikimin e kurrikulave në këto dy institucione, ndërsa elementi i tretë ka të bëjë me ngritjen e një marrëdhënieje bashkëpunimi mes këtyre shkollave dhe përfaqësuesve të sektorit privat. Elementi i fundit lidhet me mbështetjen buxhetore e sektoriale që merr ky sektor në përgjithësi nga BE-ja.

Për sa u përket aktiviteteve konkrete, unë po përmend disa nga më kryesoret, nëse doni të hyj në detaje. Për ngritjen e qendrës multifunksionale të Fierit, aktivitetet e parashikuara kanë të bëjnë me rehabilitimin e infrastrukturës, me blerjen e materialeve, pajisjeve, ngritjen e laboratorëve të domosdoshëm në këtë shkollë. Gjithashtu është parashikuar edhe një asistencë institucionale teknike.

Në lidhje me komponentin e dytë, pra me kurrikulat, në vetë konceptin e një qendre multifunksionale janë tri elemente kryesore: ofrimi i arsimit të mesëm profesional, ofrimi i kurseve afatshkurtra, që nuk janë vetëm për të rinjtë, por për të gjitha grupmoshat, domethënë edhe për ata fermerë, të cilët mund të kenë nevojë për një kurs 1, 2, apo 6-mujor në një fushë të caktuar për të zhvilluar njohuritë e tyre. Shkollat tona të mesme profesionale, dhe në rastin konkret shkolla e Fierit, do ta ofrojnë këtë lloj shërbimi.

Elementi i tretë dhe shumë i rëndësishëm ka të bëjë me kurrikula për arsimin pas të mesëm, domethënë ata që mbarojnë arsimin e mesëm profesional, të kenë aftësi dhe mundësi të ndjekin arsim pas të mesëm, që do të jetë diçka e ndërmjetme mes arsimit të lartë dhe atij të mesëm.

Elementi i katërt, shumë i rëndësishëm, është çështja e praktikave profesionale e këtyre individëve pranë biznesit, sidomos në fushën e bujqësisë ku konkretisht bëhet fjalë për shkollën multifunksionale në Fier. Është shumë e rëndësishme që një pjesë e praktikës profesionale të këtyre të rinjve e të rejave të ndodhë pikërisht në ndërmarrjet e rajonit.

Elementi i pestë ka të bëjë me ngritjen e marrëdhënieve eficiente me palët e treta (konkretisht shkolla multifunksionale e Fierit duhet të ofrojë shërbime për palët e treta), sikurse dhe pilotimi i paktit territorial për arsimin formimin profesional dhe punësimin.

Normal që kjo marrëveshje parashikon edhe detyrat reciproke si për palën shqiptare, ashtu dhe atë italiane. Për sa i përket palës shqiptare detyrat kryesore që lindin, në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, kanë të bëjnë me mundësinë për t'u lidhur me shërbime dhe programe të tjera, që mund të ofrohen nga Ministria e Bujqësisë, nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, me akreditimin dhe realizimin e moduleve të trajnimit për shërbimet e ekstensionit, bursa, etj. Për sa i përket anës italiane ka të bëjë më tepër me ofrimin e

trajnimeve ndërkombëtare, me binjakëzimin me shkollat e tjera të arsimit dhe formimit profesional e, natyrisht, edhe me shkëmbimin e praktikave më të mira.

Në lidhje me termat financiarë të kësaj marrëveshjeve, bëhet fjalë për 5 milionë euro me një periudhë maturimi prej 22 vitesh dhe me normë interesi zero.

Jam e hapur për çdo lloj pyetjeje që të kenë.

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji që po diskutojmë sot ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit. Nëpërmjet këtij projektligji Cassa Depositi e Prestiti angazhohet t'i akordojë vendit tonë një kredi të butë prej 5 milionë eurosh, për financimin e programit të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit. Kredia e butë ka një kohëzgjatje prej 22 vjetësh dhe norma e interesit është 0%.

Në mënyrë të hollësishme rezultatet e pritshme nga miratimi i kësaj kredie janë këto: favorizimi i hyrjes në botën e punës të studentëve të institutit bujqësor “Rakip Kryeziu” në Fier dhe Institutit Mekanik Bujqësor në Lushnjë. Së dyti, ngritja e një qendre multifunksionale trajnimit në institutin bujqësor “Rakip Kryeziu” në Fier, së treti, fuqizimi i Institutit Mekanik bujqësor në Lushnjë.

Së katërti, përpunimi dhe transmetimi i kurrikulave arsimore të studentëve, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian.

Së pesti, krijimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe efikase mes dy shkollave profesionale dhe tregut të punës në sektorin e bujqësisë dhe atë agroushqimor.

Së fundi, sigurimi i koherencës dhe sinergjisë me programin IPA II në Shqipëri, për sa i përket punësimit dhe formimit profesional.

Gjithashtu, te nenet e marrëveshjes janë vendosur klauzola, që parashikojnë që kredia të mos përdoret për të financuar taksat vendore, detyrimet doganore apo TVSH-në, si dhe në rast të mospërdorimit të fondeve të disbursuara, brenda 24 muajve nga data e disbursimit ato do t'i kthehen menjëherë bankës.

I rëndësishëm për t'u përmendur është edhe kontributi ndër vite i shtetit italian për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë në procesin e integritimit në Bashkimin Europian, si dhe angazhimi financiar i dhënë nga Cassa Depositi e Prestiti për disa

projekte të rëndësishme në fusha të ndryshme, si: infrastruktura rrugore, energjia elektrike, telekomunikacioni i integruar apo linjat hekurudhore.

Në përfundim të relacionit, duke qenë se nëpërmjet programit të arsimit dhe formimit profesional, nëpërmjet inovacionit, arrihet të realizohet vizioni i qeverisë, i shprehur në strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësim 2014-2020, që në fund shërben për pasjen e një ekonomie konkurruese dhe një shoqërie gjithëpërfshirëse, që bazohet në aftësi, në nivel më të lartë dhe punë më të mira për të gjitha gratë dhe burrat deri në vitin 2020, i propozoj komisionit miratimin e projektligjit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi!

Kush ka pyetje?

Zoti Haxhinasto...

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit për paraqitjen!

Që në vitin 2013, arsimi profesional dhe punësimi kanë qenë prioritetet madhore të qeverisë, të maxhorancës, që është akoma në maxhorancë.

Dikush mund të mendojë se mbas 5-6 vjetësh gjërat *soft* të arsimit profesional do të jenë zgjidhur, do të jenë konsoliduar, sqaruar, investuar e kështu me radhë.

Po shoh me shqetësim që vazhdojmë të marrim kredi për çështje menaxheriale, për çështje kurrikulash (se e lexova në relacionin tuaj), për organizim dhe zhvillim shkolle, zhvillim dhe aplikim kurrikulash, marrëdhënie me të tretë e të tjerë, ndërkohë që pritshmëria do të ishte që një kredi e tillë të merrej për të çuar një shkollë profesionale ose disa shkolla profesionale në një nivel të ri dhe rezultatet e pritshme nuk do të ishin të rehabilitohet infrastruktura apo të blihen disa pajisje, por sa njerëz do të punësohen mbas kalimit në këto shkolla, se si do të ndikonte kjo në ekonominë bujqësore të asaj zone. Këto janë rezultatet e pritshme të ndërhyrjeve të tilla, nuk janë kurrikulat. 5 milionë euro kredi!

Kurrikulat, më mirë se i dinë specialistët tanë të bujqësisë, nuk i di kurrkush.

Pra, unë shoh me shqetësim (edhe në aktin që diskutuam dje) që marrim kredi dhe i përdorim për çështje menaxheriale, për çështje programesh dhe kurrikulash, ndërkohë që këto kapacitete i kemi këtu dhe këto para duhet t'i shfrytëzojmë në mënyrë shumë më efikase, për të rritur punësimin.

Prisja që një kredi e tillë të vinte me shifra: “Ja, po investohen kaq, por do të punësohen kaq njerëz në sektorin bujqësor. Do të krijohen këto kapacitete”, që nuk i kemi dhe jo llafe menaxhime dhe kurrikula, marrëdhënie me të tretët...

Ndikuaka kjo kredi për të përmirësuar marrëdhëniet me të tretët?! Po pse, nuk bëhen dot marrëdhëniet me të tretët tani?

Nuk e dimë ne se si duhet të bashkëpunojë shkolla profesionale me sektorin privat?

Nuk e dimë ne që shkollat profesionale duhet të marrin një herë imputet nga sektori privat, në bazë të kërkesave që kanë, dhe pastaj të krijojnë kurrikulën? Presim të marrim 5 milionë euro kredi që ta bëjmë këtë?

Pra, pyetja ime është: pse vazhdojmë që rezultatet e pritshme të kredive, që do t'i paguajmë (janë para publike këto. Kreditë nuk janë falas, por janë para që kthehen mbrapsht) të mos i investojmë siç duhet? Pse nuk i investojmë, që të krijojmë vërtet mundësi reale punësimi?

Pse i tresim në menaxhime, në bashkëpunime, pa ndonjë rezultat konkret në sektorin bujqësor, i cili është prioritet kombëtar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bujqësia.

Sektori bujqësor është sektor prioritar dhe ne i hedhim paratë për gjëra menaxheriale, kur bujqësia pret vërtet investime konkrete, investime të mirëfillta dhe integrale, sepse një sektor nuk zhvillohet duke bërë arnime këtu dhe arnime atje, por duhet menduar për të gjithë sektorin në tërësi. Kjo është pyetja ime.

Kam edhe një shqetësim, zoti kryetar. Këto kreditë e fundit që kemi trajtuar në këtë komision, më duket se janë tretur pak si shumë hollë.

Kështu që u bëj thirrje edhe kolegëve të tjerë t'i shikojnë me kujdes, se vërtet janë kredi, por do të paguhen një ditë. Janë para publike dhe duhet të jemi shumë të përgjegjshëm kur trajtohet mënyra e përdorimit të tyre.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Zoti Spaho, mund të kthejë një përgjigje zonja zëvendësministre dhe pastaj ta merrni ju fjalën?

Urdhëroni, zonjë!

Dajna Sorensen – Për sa i përket pjesës së alokimit të fondeve, do të doja të sqaroja që shumica e fondeve nuk shkojnë për kurrikula. Absolutisht, është rezultati i parë, sipas planit financiar që është dorëzuar, ku 3,7 milionë euro nga 5 milionë euro shkojnë kryesisht për rehabilitimin e ambienteve, ngritjen e laboratorëve, që janë kaq të domosdoshëm në këtë shkollë.

Elementi tjetër që do të doja ta nënvizojë është: sektori i bujqësisë, ashtu si çdo sektor tjetër ekonomie, ndryshon në mënyrë të vazhdueshme. Nevoja për laboratorë të përditësuar është një nevojë që nuk bëhet vetëm me një investim në këtë fushë, por është një investim që kërkohet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme.

Për sa i përket çështjes së punësimit dhe numrit të njerëzve, të cilët impaktohen nëpërmjet ndërmarrjes së një projekti të tillë, do të thosha se nuk ka aspekt më të rëndësishëm në punësimin e një individi sesa aftësitë me të cilat ai njeri pajiset. Në qoftë se ne investojmë në kurrikula, që janë cilësore, që u përgjigjen nevojave që ka tregu ynë sot, kjo është pajisja më e mirë e këtyre individëve me aftësitë e duhura që tregu i punës kërkon.

Në shifra konkrete, aktualisht në dy shkollat profesionale, që do të përfitojnë nga ky program, kemi rreth 1000 nxënës, të cilët janë të regjistruar. Aktualisht, në këtë vit akademik, 300 prej tyre dalin automatikisht në tregun e punës. Domethënë, në 22 vjet financim, ne presim, me një llogari të thjeshtë, të jenë 6000 e disa vetë, që do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke qenë më të aftë për t'u integruar në tregun e punës.

Përtej kësaj, kur shpjegova konceptin e qendrave multifunksionale, nënvizova faktin se qendrat multifunksionale në thelbin e tyre kanë zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive të individëve. Me pak fjalë, në një treg pune që evoluon me një shpejtësi marramendëse, ku njerëzit duhet t'i përditësojnë aftësitë e tyre, nuk mjafton të kesh mbaruar një shkollë profesionale këtu e 10 vjet më parë dhe aftësitë e tua të mbeten relevante në treg, por duke ofruar kurse afatshkurtra, të cilat u përgjigjen nevojave për aftësi të individëve të ndryshëm, do të mundësojë që njerëzit, minimalisht 2000 në vit, të plotësojnë aftësitë e tyre nëpërmjet kurseve afatshkurtra. Thelbin e qendrave multifunksionale, si koncept në vetvete, po e shpikim ne. Jemi në një koncept, që po mundohemi ta zhvillojmë në të gjitha institucionet e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri. Është një model që e kemi ndërtuar në bashkëpunim me Bashkimin European.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit ju!

Zoti Haxhinasto, mund të reagoni pas zotit Spaho, se ka një ndërhyrje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Zoti Haxhinasto...

Edmond Haxhinasto – Patjetër, unë e kam shumë të qartë se si funksionojnë qendrat multifunksionale, por pyetja ime vazhdon të jetë: me kredi presim t'i bëjmë këto gjëra ne? Të

marrim kredi dhe mbas 6 vjetësh qeverisjeje... Nuk e kemi të qartë se si duhet t'i zhvillojmë shkollat që janë në qendrat kryesore të zhvillimit bujqësor? Kjo ishte e para.

E dyta, vërtet po dalin 300 nxënës nga këto shkolla, por a janë të punësuar këta? A janë të gjithë të lidhur me sektorë të caktuar ose...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, koleg! Të lutem!

Lidhjen me prodhimin, me sektorin privat, presim ta bëjmë me kredi? Nuk e dimë ne që duhet të jetë i lidhur sektori privat me shkollat profesionale?

Ju e keni vënë këtu. “Me këtë kredi,- thoni,- do të përmirësojmë marrëdhëniet me të tretët.” Do të bëhet me kredi kjo?

Unë nuk e kam merakun konkretisht se po e merr Lushnja apo po e merr Fieri. Nuk kam probleme të tilla, as që ju po investoni në laboratorë. Shumë mirë që investoni në laboratorë. Unë e kam merakun se pse presim kredinë që të zhvillojmë marrëdhënie të tilla.

Këto janë gjëra shumë të qarta, shumë të thjeshta për t'u bërë. Këtu duhet një vullnet dhe një koncept i qartë. Nuk ka nevojë të merret kredi që të zhvillohet marrëdhënia midis shkollës dhe sektorit privat. Këtë jam duke thënë.

Erion Braçe – Do të flasë zoti Spaho. Reagoni më pas.

Edmond Spaho – Duke marrë shkas nga ajo që tha zoti Haxhinasto, “Bujqësia është sektor prioritar”, si dhe nga ajo që tha zonja zëvendësministre, “Bujqësia është dinamike, ka nevojë për laboratorë dhe në varësi të kohës dhe nevojave, përpiqemi ta mbështesim”, po ju jap një lajm (ndoshta mund ta keni lexuar dhe mund të jeni informuar nga sukseset në sektorin e bujqësisë). Meggle iku, na la. Besoj se e dini cila është. Është firma më e madhe gjermane e përpunimit të qumështit dhe produkteve blegtorale. Kishte hyrë në Shqipëri në vitin 2010. Prodhuesja më e madhe në Shqipëri, me kapacitet 35 milionë litra. E vetmja kompani në Shqipëri që prodhonte qumësht UHV. Përveç qumështit, prodhonte edhe djathë, si dhe të gjitha nënproduktet e tjera blegtorale, me teknologjinë më të mirë (nuk besoj se e vini në dyshim). Është kompania më e madhe në Gjermani. Përse u largua?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju shpjegoj pse u largua.

Së pari, nga konkurrenca e pandershme. Kur këta e grumbullonin qumështin cilësor me 50 lekë për litër, të tjerët grumbullonin çdo lloj qumështi me 30 lekë për litër. Pavarësisht se ishte prodhuesja dhe shitësja nr. 1 në Shqipëri, ajo nuk i mbulonte dot kostot.

Së dyti, nga një studim që kanë bërë autoritetet përkatëse, del se 65% e qumështit grumbullohet në mënyrë informale, nga kompani dhe baxho të paregjistruara. Nga 450

(shikojë, po t'i them me përgjegjësi) baxho një Shqipëri vetëm 150 prej tyre janë të regjistruara. Prandaj nuk ka treg për Meggle-n dhe iku e çau ferrën!

E treta, konkurrentët, AKU-ja dhe media e blerë, iu vunë me objektiv të qëllimshëm dhe e akuzuan se shet qumësht me alfatoksinë.

Kam parë vetë emisione në disa televizione, ku çirreshin dhe përhapnin panik derisa bindën qytetarët që produktet e këtij gjiganti të qumështit dhe të prodhimeve blegtorale janë të rrezikshme për shëndetin e tyre, derisa e bënë të falimentojë për shkak të këtij sulmi të poshtër dhe të qëllimshëm të konkurrentëve jo të ndershëm, që përkrahen edhe nga institucionet shtetërore për shkak të ryshfetit që marrin dhe të parasë. Ky është rezultati i politikave zhvillimore dhe i asaj që themi se bujqësia është prioritare, por në fakt, largojmë firmat më të mëdha dhe më të njohura gjermane.

Erion Braçe – A keni ndonjë reagim për ato që tha zoti Haxhinasto më përpara?

Zoti Spaho, jo për këtë, sepse kjo mbetet për t'u verifikuar.

Dajna Sorensen - Do të thosha vetëm kaq: nuk shoh ndonjë diferencë ndërmjet investimeve të fondeve publike në fund të ditës. Arsimi profesional është i kushtueshëm, ai kërkon investime të vazhdueshme.

Nuk arrijmë t'i mbulojmë të gjitha. Nevojat e shkollave profesionale janë: buxheti i arsimit profesional...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Kam disa pyetje, por dua të bëj edhe një koment për atë që tha zoti Spaho, duke tentuar ta trajtoj që në vitin 2010, kur ekonomia shqiptare lulëzonte në të gjitha anët dhe kompanitë e mëdha, kryesisht edhe ato gjermane erdhën në Shqipëri dhe gjetën një treg...

Erion Braçe - Zoti Pëllumbi e lëmë komentin...

Arben Pëllumbi – I gjithë qumështi mblidhej në mënyrë legale dhe vitet e fundit kjo punë filloi të mos funksionojë si duhet. Nuk më duket se është kështu.

Edmond Spaho - Unë nuk thashë asgjë të tillë. Për fat këtu kemi disa dëshmitarë. Unë thashë se ka hyrë në vitin 2010 dhe iku në vitin 2018. Arsytet pse iku janë këto që po them unë.

(Zoti Pëllumbi flet pa mikrofon)

Po, pra janë sot, por se sa kanë qenë në vitin 2010 nuk e di.

Arben Pëllumbi - Atëherë, mësoje dhe pastaj na bëj edhe deklaratat.

Edmond Spaho – Arsytet pse ikën sot, nga 450 në 150 janë të regjistruara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe- Zoti Pëllumbi, një sekondë!

Edmond Spaho- Unë nuk po bëj politikë, ti do të bësh politikë. Po të them se iku edhe për shkak të sulmit të organizuar që iu bë duke gënjyer qytetarët shqiptarë që prodhimet e një kompanie kaq të njohur u tha se ishin me aflatoksinë. Ata të cilët kanë teknologji mizerabël sot e shesin si produkt cilësor të nivelit më të lartë.

(Zoti Pëllumbi flet pa mikrofon)

Kjo është politika që ndjek AKU-ja, Ministria e Bujqësisë dhe të gjitha organizmat e tjera shtetërore.

Arben Pëllumbi- Nuk është aspak kështu.

Erion Braçe - Zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi- Kompanitë shkojnë dhe vijnë. Kjo është ekonomia e tregut. Këtë lloj ekonomie ndërtojmë, dikush fiton, dikush humbet. Kanë falimentuar dhe gjigantë shumë më të mëdhenj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edmond Spaho ---që vijnë nga Europa, nga Gjermani, firmat më me reputacion. Pse nuk humb në Europë kjo, por vetëm në Shqipëri? Pse nuk humb në Maqedoni? Pse nuk humb në Kosovë? Pse nuk humb në Serbi? Këtë më shpjego ti, jo të na tregoni përralla!

Arben Pëllumbi- Vetëm negativitet shikoni në ekonomi.

Erion Braçe – Zoti Pëllumbi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi - Kanë ardhur 10 –të të tjera.

Edmond Spaho – Cilat? Më thuaj një emër?

Erion Braçe - Ta them unë, por na le të flasim.

Zoti Spaho për shkak se e njoh shumë mirë këtë pjesë po ju them se të paktën 3 kompani që operojnë në rrethin e Lushnjës janë të gjitha me certifikatën e BE-së, me ISO, standardet e BE-së.

Edmond Spaho - Nuk e vë në dyshim që janë me certifikatë.

Erion Braçe - Zoti Spaho!

Edmond Spaho - Ti nuk mban lidhje me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi - ...vjedhje janë edhe këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Zoti Spaho të tria kompanitë aplikojnë teknologjinë e fundit fare të blerë në Suedi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po më referoni njërën, unë po ju them 3, që janë trendet më të mëdhenj në treg.

Ndërkohë që më lejoni t'ju them...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, dakord, do ta verifikojmë, për këtë do të kërkoj informacione. Shqetësim është edhe kjo që thoni ju, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi, më fal!

Zoti Spaho këtu e 6 vjet më parë një tjetër kompani me pronar shqiptar shumë të njohur edhe midis meje dhe jush, e nxorën nga tregu në të njëjtën formë që po thoni ju, me dhunë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, a ka mundësi ta mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, a ka mundësi të më dëgjosh!

Unë nuk e di se si është larguar kjo që po thoni ju, për herë të parë po e dëgjoj tani. Pa asnjë lloj diskutimi do të kërkoj verifikim. Por po them se i njëjti standard është aplikuar edhe për një kompani tjetër, e nxorën nga tregu me dhunë, e shkatërruan nga tregu në Kosovë, nga tregu në Shqipëri. Nëse është kjo praktikë, pa asnjë lloj diskutimi që është e dënueshme, por nga ana tjetër nuk mund ta pranoj logjikën, se të vegjlit nuk duhet të punojnë në këtë vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, a ka mundësi?

Unë kam 4 baxho në zonë dhe po ju them nuk ka javë që të mos u shkojë në derë AKU-ja. Ndoshta këta kanë fatin e keq që kanë rrugët afër dhe te këta shkohet pak më shpejt, por unë nuk mund t'i ndal këta.

Më fal!

Edhe njëherë, unë nuk mund t'i ndaloj që ta grumbullojnë qumështin e atyre njerëzve aty në zonë. Do të punojnë edhe këta të vegjlit, nuk do të punojnë vetëm të mëdhenjtë. Ky lloj përqendrimi thjesht dhe vetëm tek të mëdhenjtë ka bërë atë që është shqetësimi ynë dhe juaji i madh, që këta të mëdhenjtë diktojnë pastaj edhe çmimet. Më shumë lekë marrin këta të mëdhenjtë, sesa merr ai fshatari që prodhon qumështin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është populizëm, kjo është e vërteta.

Të mbarojë pyetjet zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Zonja Zëvendësministre, nisur nga fakti se INSTAT-i ka publikuar shifrat për tremujorin e parë të këtij viti ku papunësia ka zbritur në nivelin më të ulët historik në 12,5%, do të doja t'ju pyesja: sa është numri i shkollave profesionale publike dhe jopublike sot, i qendrave multifunksionale? A kemi një numër të saktë të nxënësve që kanë mbaruar këto shkolla? Sa prej tyre kanë arritur të gjejnë punë?

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Aktualisht ne kemi 35 shkolla publike, të mesme të arsimit profesional, 10 qendra të formimit profesional. Shkollat ofrojnë programe afatgjata katërvjeçare, ndërsa qendrat ofrojnë programe afatshkurtra që variojnë nga disa muaj maksimumi deri në 6 muaj. Përveç tyre janë licencuar edhe shkolla private të arsimit profesional, me sa di unë janë 10 të tilla, janë mbi 500 qendra private të formimit profesional që ofrojnë kurse afatshkurtra.

Për sa i përket numrit të personave të cilët mbarojnë, diplomohen çdo vit mesatarisht, presupozjmë se për këtë vit akademik janë rreth 3 mijë individë, të cilët marrin diplomën në arsimin e mesëm profesional, nga 19 mijë që është numri i nxënësve që ndoqën vitin akademik 2017-2018. Nëse krahasojmë punësimin e atyre që janë diplomuar në arsimin e mesëm profesional me ata që kanë arsimin e mesëm të përgjithshëm është rreth 10% më e lartë punësueshmëria e atyre që kanë arsim të mesëm. Nëse shikojmë se çfarë ka ndodhur me ata që u diplomuan në fund të qershorit të vitit të kaluar, pamë sa prej tyre u integruan direkt në tregun e punës, kemi 42% të tyre që integrohen në mënyrë imediate në tregun e punës, një pjesë e tyre vazhdojnë studimet e larta, një pjesë janë të papunësuar ende.

Arben Pëllumbi- Faleminderit!

Qëllimi i pyetjes sime ishte në vazhdim të asaj që tha zoti Haxhinasto, se jemi duke aprovuar sot një kredi për ndërhyrje në një shkollë dhe në një qendër profesionale, ndërkohë që kemi 35 të tilla. Gjatë kësaj periudhe janë bërë investime, qoftë nga donatorët, qoftë nga grantet apo nga buxheti i shtetit dhe jemi duke aprovuar një kredi vetëm për ndërhyrjen në një shkollë. Nuk po marrim kredi, se nuk dimë të bëjmë gjë, por kaq sa e kemi rritur numrin e shkollave dhe të qendrave profesionale, ka disa shkolla dhe disa probleme të caktuara që kanë nevojë të ndihmohen me kredi, nëse e kuptova saktë.

Dajna Sorensen – Për sa u përket vlerave konkrete, se sa është investuar në shkollat e arsimit profesional, ndoshta kolegët e mi mund të më ndihmojnë me shifrat e sakta.

Investimet në arsimin profesional, sikurse e përmendët kanë qenë gjithmonë në rritje në këto vite dhe në një pjesë të madhe të shkollave është investuar. Por një mësim nga e gjithë eksperiencia që kemi pasur, qoftë me donatorët, qoftë nga vetë investimet publike të shtetit shqiptar, është vënë re dhe është e domosdoshme që investimi të jetë integral, të përfshijë jo vetëm investime në laboratorë, në pajisje dhe rehabilitim të godinave e të tjera, por është shumë e rëndësishëm që paralelisht të rishikohen kurrikulat, të rishikohen modalitetet e praktikave profesionale, të shikohet mënyra se si bashkëpunohet me palët e treta. Janë të gjitha elemente që duhen parë bashkë. Në rastin e një kredie të tillë që i ka të gjithë këto elemente brenda është shumë i rëndësishëm dhe ka një garanci për një sukses më të madh sesa në rastin kur kemi një investim sporadik, por që nuk shkon bashkë me njohuritë që janë kaq të domosdoshme. Nuk është vetëm investimi infrastrukturor që e bën një shkollë më të mirë, por janë edhe njohuritë teknike që janë kaq të rëndësishme që një shkollë të funksionojë mirë.

Erion Braçe –Faleminderit!

Po, zonja Tabaku, urdhëroni!

Jorida Tabaku - Zoti kryetar, kam një pyetje për procedurë, a ka mundësi që në këtë komision të operojmë normalisht, flasim për Xhafajn, suleni kundër. flasim për Teatrin, suleni kundër, flasim për punësimin, përsëri suleni kundër. A ka mundësi që për një argument të një kolegu të mos sulet e gjithë maxhoranca kundër dhe të mos jetë dakord? A mund të ndajmë mendime të ndryshme në këtë komision?

Zoti Spaho ngriti një shqetësim serioz, se nuk ka investitorë të huaj dhe sulen të gjithë kolegët menjëherë në sulm dhe në kor, duke e justifikuar përgjigjen. E kuptoj se jeni të gjithë shumë të devotshëm për të mbrojtur qeverinë, por na lejoni edhe ne të kemi mendimet tona.

Për zëvendësministren kam disa shqetësime, së pari meqenëse edhe zëvendësministrja m'u përgjigj këtu e para një muaji, kur ngrita shqetësimin për punësimin dhe për të dhënat që kishte publikuar INSTAT-i, një nga arsyt kryesore pse i kërkoja të dhënat fiskale të Ministrisë së Financave është pikërisht lidhja që kanë me punësimin. Nëse do të ishin punësuar kaq sa thotë INSTAT-t, 60 mijë dhe do të arrinim në nivele rekord, më të ulëta të punësimit në Shqipëri, të ardhurat minimale që duhet të kishin ardhur për tremujorin e parë të vitit 2018 duhet të ishin të paktën 40 milionë dollarë më të larta për sigurimet shoqërore, ndërkohë që këto të fundit krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2017 janë rritur vetëm 1 miliard, pothuajse mesatarisht 10 milionë dollarë. Tatimi mbi të ardhurat personale për tremujorin e parë të vitit 2017 krahasuar me vitin 2018, nëse do të kishim atë numër të

punësuarish, duhet të ishte rritur edhe tatimi mbi të ardhurat personale, po me të njëjtin rritëm, ndërkohë që edhe ky i fundit është rritur vetëm 1 miliardë.

E njëjta gjë edhe me sigurimet shëndetësore. Ku i keni gjetur 60 mijë të punësuar, ku janë? Në zyrat e punës, thatë se ofrojnë informacion për vende pune: 407 punë aktive, thoshte informacioni i zyrës së punës në datën 4 korrik, 88 mijë e 862 punëkërkues, (zyra e punës që menaxhohet nga ju), sepse ne nuk kemi ndonjë zyrë pune në parti. 5300 kompani që ofrohen për të punësuar këta persona, 88 mijë sot kërkojnë punësim. Megjithëse ka ndryshuar legjislacioni, megjithëse e dini shumë mirë se nëse i ofron një punë një mekaniku në Tiranë dhe e çon në Pukë, ai e refuzon, ti e heq nga forca aktive e punës, megjithëse ka ndryshuar dhe nëse merr 1 muaj punësim ose nëse paguhet 3 muaj ti fillon dhe llogarit metodologjinë me listat e pagesës që ka ndryshuar INSTAT-i për periudha të ndryshme. Me gjithë këta pa llogaritur efektin e emigrimit, pasi thatë se nuk ka ndikuar emigrimi, ku janë gjetur 60 mijë të punësuar, kur nuk kanë paguar sigurimet shoqërore, nuk kanë paguar tatimin mbi të ardhurat personale, kur në zyrën e punës janë vetëm 407 vende bosh?

Kam edhe dy pyetje të tjera. Çfarë efektesh kanë pasur zyrat e punësimit në punësimin gjigant dhe stratosferik që ka ofruar qeveria këta 5 vjetët e fundit? Bashkohem me mendimin e zotit Haxhinasto. Këtu në këtë komision, sa herë që ka ardhur një kredi, unë kam ngritur një dhe vetëm një shqetësim: fondet dhe paratë po shkojnë për asistencë teknike. Këtë e kam ngritur në çdo lloj kredie që është diskutuar këtu, e ngre edhe në këtë rast. Zoti Haxhinasto ia vuri emrin çështje manaxheriale, unë po e quaj asistencë teknike. Është e pamundur për buxhetin e shtetit të vazhdojmë dhe të marrim kredi për asistencë teknike. Besoj se të parin zotin Luçi që e keni ngjitur, por edhe ne ju kundërshtojmë kur themi se nuk janë njëlloj paratë publike me kredinë. Meqenëse jeni zëvendësministre e Financave duhet ta dini se nuk kushton njëlloj kredia me paratë publike, nuk është njëlloj si të bësh investime në një shkollë të arsimit profesional me fondet të buxhetit të shtetit dhe të marrësh një kredi, janë dy gjëra totalisht të ndryshme. E thatë para dhjetë minutave. Ka logjikë rritja e investimeve në arsimin profesional, në bujqësi, por unë mendoj se në bujqësi kemi probleme të tjera shumë të mëdha. Skema e granteve përsëri ka dështuar, jemi në mesin e vitit. Nëse do qeveria shqiptare të shpenzojë fonde për kredi, le t'i marrë për këtë fushë, përsëri infrastrukturë deri në mesin e vitit, për bujqësinë, për ujësjellës dhe me radhë. Nuk është se kemi ne atë nivel që e ka të nevojshëm fshati, kështu që ose do t'u përgjigjemi nevojave të tregut ose do të investojmë në bujqësi në këto fusha, ose do të bëjmë një studim për nevojat që ka tregu dhe do t'i përgjigjemi investimit në arsimin profesional. Më duket se diçka nuk

shkon në strategjinë që ka qeveria, së pari me punësimin dhe së dyti, me sektorët që duhet të mbështeten.

Dajna Sorensen – Për sa i përket reflektimit të shifrave të punësimit jam e disponueshme t'ju kthej përgjigje me shkrim, për çfarëdo lloj pyetje që keni, për reflektimin të sigurimet shoqërore dhe shëndetësore apo reflektimin të pagesa e tatimtaksave. Duhet t'i kontrolloj, sepse ato shifra nuk i kam me vete në këtë moment dhe pastaj do t'ju kthej përgjigje brenda ditës, pasi nuk është problem.

Për sa u përket shifrave që nxorët nga vendet e lira të punës të zyrat e punës në këtë moment absolutisht nuk janë 400 e ca...

Erion Braçe - Është një zyrë pune.

Dajna Sorensen- Nuk e di çfarë është ajo dhe ku e keni nxjerrë. Mund të qëndrojmë bashkë dhe t'ju tregoj *online*, të disponueshme se sa vende të lira pune ka.

Erion Braçe - Zonja Tabaku thotë se është zyra e punës së Tiranës.

Dajna Sorensen – Tirana mund të ketë në këtë moment 400 aktive, nesër mund të ketë 1400 aktive, nuk është e thënë të jenë...

Jorida Tabaku - Nuk dua t'ju ndërpres, por ideja ishte 88 mijë e 800 kërkesa për 407 vende.

Dajna Sorensen- E para, 88 mijë vetë nuk janë në Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë. 400 e ca vende pune janë në Tiranë. Po krahasoni 2 gjëra që nuk janë të krahasueshme me njëra-tjetrën.

E dyta, për sa i përket performancës së zyrave të punës, në këtë moment kam shifrat se sa kanë punësuar zyrat e punës çdo muaj. Aktualisht në muajin paraardhës numri i personave të punësuar nëpërmjet zyrave të punës në Shqipëri ka qenë 3591 persona që janë punësuar nëpërmjet zyrave të punës. Një muaj më parë ka qenë 3434, një muaj më parë ka qenë 2796.

Për sa i përket numrit të vendeve të punës që deklarohen nga biznesi pranë zyrave të punës, minimalisht sot kemi vetëm 54% e vendeve të punës që dorëzohen nga biznesi, jemi në gjendje t'i ndërmjetësojmë. Minimalisht ne kemi pothuajse dyfishin e vendeve të lira të punës aktive në këtë moment krahasuar me numrin e personave që punësojmë. Kjo është një shifër shumë domethënëse. Në rastin konkret 400-shja nuk qëndron, por megjithatë për Tiranën do ta kontrollojmë.

Një element tjetër, shifrat që shikoni *online* nuk reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë numrin e vendeve të lira, të cilat janë të deklaruara të zyrat e punës, sepse jo të gjithë bizneset janë dakord që t'i shpallin vendet e tyre *online*. Një pjesë e madhe

e tyre preferojnë të mos i shpallin *online*, sepse rreshtohen njerëzit para dyerve të tyre dhe preferojnë t'i shpallin në zyrat e punës. Numri është shumë më i lartë sesa ai që shikoni në *website*-in e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Besoj se ju përgjigja pyetjes.

Erion Braçe – Zonja Tabaku, për të ardhurat nuk ju përgjigjet dot zonja, ju thamë se brenda orarit zyrtar të ditës së sotme do të merrni të ardhurat dhe çdo gjë tjetër. Nëse ju dëshironi të kryqëzoni të dhënat që kërkon, për 2 ditë, zonja t'ju kthejë përgjigje me shkrim për të gjitha çfarë kërkuat.

Ka pyetje? Po zoti Bushaj.

Xhevit Bushaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe zëvendësministres për ekspozenë që i bëri projektligjit. E vlerësoj maksimalisht këtë marrëveshje.

Si përfaqësues i Qarkut të Fierit, por njëkohësisht duke parë edhe historikun e dy institucioneve shumë të rëndësishme, njëri që përgatit teknikienë dhe profesionistë për bujqësinë, kurse tjetri profesionistë për mekanikën, pra, mendoj se këto dy institucione i shërbejnë një dege shumë të rëndësishme të ekonomisë shqiptare, e cila është bujqësia.

Nga historiku, por edhe nga ajo çka ofrojnë të dyja shkollat, unë mendoj ato u shërbejnë jo vetëm nxënësve dhe studentëve të Qarkut të Fierit, por edhe të qarqeve të tjera, duke përfshirë këtu Beratin, Vlorën, Gjirokastrën dhe Korçën.

Pyetja ime ka lidhje me infrastrukturën dhe akomodimin e studentëve të këtyre zonave. Nuk e di nëse është i përfshirë ky zë i veçantë, sepse duke njohur edhe situatën dhe gjendjen atje e di se ka pengesa, siç thatë ju, për laboratorët apo bazat eksperimentale që përdoren në të dyja shkollat. Pastaj është edhe problemi i akomodimit të studentëve të këtyre qarqeve.

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni!

Dajna Sorensen – Projekti përmbledh të gjithë infrastrukturën e shkollës, konvikti është brenda oborrit të shkollës dhe brenda kompleksit bujqësor. Pra, e gjithë infrastruktura dhe laboratorët do të jenë: kompleksi i shkollës, konvikti dhe baza prodhuese, që është toka bujqësore. Pra, e gjithë kredia do të shkojë për rehabilitimin dhe ndërtimin si të konviktit, shkollës, ashtu edhe të kompleksit bujqësor, përfshi edhe stallat e lopëve.

Xhevit Bushaj - Faleminderit!

Sektori i bujqësisë në Qarkun e Fierit ka nevojë edhe për kurse afatshkurta, sepse dihet që në situata të veçanta kërkesat e bujqësisë janë të rëndësishme. Për shembull: në

terren ne nuk gjejmë sot shartesorë që të shartojnë qoftë fidanët e bostaneve apo shalqive, qoftë edhe në frutikulturë, kështu që këto kurse do të ishin shumë eficiente dhe do të jepnin një risi dhe një ndihmë kolosale zhvillimit të bujqësisë në këto zona dhe plotësimit të nevojave në kohë sezoni.

Erion Braçe – Urdhëroni!

Dajna Sorensen – Sikurse e përmenda edhe më parë Qendra Multifunksionale do të ofrojë pikërisht këtë që thoni ju, kurse afatshkurta që do t’u shërbejnë nevojave të biznesit, nevojave të individëve pikërisht për këto specialistë që janë kaq të munguar në tregun e punës.

Erion Braçe – Urdhëroni!

Evis Kushi – Kisha një koment të shkurtër, meqenëse u fol këtu disa herë për zyrat e punës dhe rezultatet e këtyre zyrave. Nuk e kam aspak për politikë, por dua të them se pas shumë vjetësh, më në fund, zyrat e punës po i rikthehen funksionimit të tyre normal dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për vitet e qeverisjes së PD-së, por e kam fjalën edhe për mandatin e parë të qeverisjes sonë, kur rezultatet nuk ishin këto që janë sot.

Vetëm ky vit i parë i këtij mandati të dytë ka shënuar një hop shumë cilësor. Më në fund marrëdhënia e zyrave të punës me biznesin është shumë e ngushtë dhe njerëzve u është kthyer besimi.

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni!

Edmond Haxhinasto - Faleminderit!

Po marr spunto nga kolegu parafolës, i cili bëri një pyetje shumë të drejtë, kur përmendi disa specialistë për të cilët ka nevojë bujqësia. Ne nuk duhet të presim këtë kredi, se nuk çështja se gjetëm një projekt, na e dhanë italianët një kredi 5 milionë dhe ne tani do të zgjidhim këto probleme që ka bujqësia. Ky është një problem i përgjithshëm.

Në Përrenjas ka qenë shkolla e vetme teknike, se tani është në një situatë shumë të rëndë, që përgatiste teknikë të minierave. Aktualisht është në punë brezi i fundit i zjarrvënësve që ndezin fitilat (për ata që janë me shkollë po flas), pastaj ndodhin defektet apo aksidentet sepse i kemi njerëzit pa shkollë nëpër miniera.

Po kështu, Cërriku ka pasur shkollën teknike më të madhe në Shqipëri për bujqësinë, ndoshta shumëkush nuk e di. Tani ajo shkollë ka nevojë për një zhvillim shumë të madh. Pra, ndërhyrja ime nuk është fare politike, se edhe ne nga ky krahu këndeje na dhemb për shkollat tona profesionale që përgatisin njerëzit dhe i krijojnë besimin për të punuar në Shqipëri dhe

arsyeja pse nuk shkojnë nëpër shkolla është se nuk kanë besimin për të punuar në Shqipëri, se nuk i gjejnë mundësitë për të marrë ato zanate që u duhen nëpër këto shkolla.

Prandaj them se nuk ka nevojë të marrim kredi për të ditur se çfarë teknikësh i duhen prodhimit. Këtë e di prodhimi, ndaj duhej ta kishin zgjidhur këtë punë prej kohësh.

Ajo që po them është se nuk kemi nevojë të marrim kredi për të zgjidhur këto gjëra, se këto gjëra kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë. Nuk kemi nevojë në këtë moment të marrim një kredi dhe të zgjidhim këtë problem në shkollë, çështjet menaxheriale apo asistencën teknike. E kam fjalën se duhet të keni një qasje, një kthjelltësi shumë më të madhe se si ta lidhim shkollën me prodhimin.

Si t'i lidhim shkollat profesionale me ato kërkesa që ka tregu i prodhimit? Pse duhet të ketë vende pune dhe të mos ketë njerëz për këto vende pune? Çfarë tregon kjo? Se nuk ka funksionuar mirë lidhja midis tregut të punës dhe shkollave profesionale. Është gjë e mirë kjo? Është politike kjo? S'është aspak politike, se edhe ikja nga Shqipëria e njerëzve pa shpresë nuk është veprim aspak politik.

Prandaj mendoj se do ta lëmë mënjatë politikën dhe të flasim shumë më konkretisht dhe shumë më në parim, e theksoj, pa ngjyra politike.

Shqetësimi im është se pse sot vazhdojmë e marrim kredi për këto çështje? Marrim kredi për asistencë teknike. A nuk e kemi të qartë ne se si lidhet prodhimi me mësimin?

Faleminderit!

Erion Braçe – Vetëm një gjë kam, zoti Haxhinasto, që kurrikula e këtyre shkollave profesionale ka ngelur ajo e para 30-40 vjetëve, që të jemi realistë. Unë e shikoj atë që është në Lushnjë, ndërkohë që është plotësisht i drejtë konstatimi juaj që tregu ka nevojë për tjetër gjë, fjala bie për traktoristë. Kanë vdekur 5-6 njerëz në një territor të caktuar atje, kanë rënë nga traktori dhe ky i ka zënë poshtë, ndërkohë që kurrikula që ofron shkolla e mesme profesionale e Lushnjës as e përfshin fare këtë kategori. Zero, s'e ka fare. Kështu që është edhe një problem, por që nuk duhet pritur, ka të drejtë zotëria, kredia për të rregulluar kurrikulat e këtyre shkollave, duhet të jenë shumë më fleksibël, sepse unë i them drejtorit ka nevojë për këtë gjë dhe drejtori thotë këtë kurrikul kam. Pse duhet pritur një model që ne do ta bëjmë Fier apo në Lushnjë për të ndryshuar kurrikulat që kanë 30-40 vjet pa u prekur, ndërkohë që Shqipëria është zhvilluar në sektorë të ndryshëm dhe ka nevoja shumë më të mëdha në këtë sektor?

Urdhëroni!

Përparim Spahiu – Sa i takon pjesës së punësimit: A keni dijeni për një raport të fillimkorrikut të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim, ku thuhet se Shqipëria zë vendin e fundit

në rajon për hapjen e vendeve të reja të punës, me 28 mijë në 7 vjet? Duket se shifrat që i dëgjojmë nga ju me shifrat që dëgjojmë edhe nga institucionet e pavarura, nuk përputhen. Tani ose ka ndodhur që pas 2013-ës ikën të gjithë nga puna dhe u rikthyen 300 mijë, ose këshilli rajonal për bashkëpunim me strategjinë në 2020-ën nuk thotë të vërtetën.

Dajna Sorensen – E kam lexuar atë raport me shumë vëmendje. Për sa u përket shifrave që raportohen aty i njoh në ajër.

(Diskutime pa mikrofon)

Për sa u përket shifrave të punësimit dhe çfarë ka ndodhur me punësimin, unë do të doja ta ndaja në dy periudha...

(Diskutime pa mikrofon)

Përparim Spahiu – Të lutem, më shkurt, a jeni dakord me raportin që Shqipëria ...

(Diskutime pa mikrofon)

Dajna Sorensen – Raporti i referohet periudhës 2010- 2017. Kjo periudhë ndahet në dy pjesë, 2010-2013, kur ka një rënie drastike të numrit të të punësuarve në Shqipëri, dhe periudha 2013-2018, kur një rritje shumë substanciale në punësim dhe automatikisht, kur bën një të mesme të përpjesshme të këtyre, vlera mesatare e vendeve të krijuara të punës është ajo që thoni ju.

Përparim Spahiu – Më duket se ju ndihmova për përgjigjen...

(Diskutime pa mikrofon)

Pjerin Ndreu – Po, në periudhën 2013-2017 kemi qenë bashkë në qeveri, ore vëlla, ke qenë mbrojtës i këtyre politikave. Apo s'e mban mend? Të paktën mos e pështyni periudhën që keni qenë me ne...

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Braçe – Mos e politizoni, ju lutem!

Përparim Spahiu – Në 4 vjet nuk kam qenë asnjëherë dakord dhe nuk e kam pranuar kurrë që në këtë vend janë punësuar 300 mijë njerëz. Edhe kur kemi qenë bashkë, edhe sot nuk e kam pranuar asnjëherë...

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Braçe – Kjo punë nuk mund të zgjidhet asnjëherë. Numri është numër. Të gjithë e njohim njësoj, po ka njerëz që e pranojnë, ka edhe njerëz që nuk e pranojnë. E vetmja gjë që ngelet në këtë histori është që një ambient të caktuar të vijë e gjithë lista e borderove, edhe borderotë e vitit 2013, edhe borderotë e tanishme. Sillini ose bëjini ju publike kur të doni me qëllim që të kuptojnë njerëzit, se ndryshe nuk e pranon askush këtë

gjë. Kjo histori nuk mund të vazhdojë kështu. Të jetë një numër. Atë numër e lexojmë të gjithë njësoj, por njëri thotë “po”, kurse tjetri “jo”. Sillni borderotë që të mbyllet historia!

Urdhëroni, zonja Tabaku!

Jorida Tabaku – Zoti Braçe, një shqetësim që sapo shpreha për vendet e punës nga zyrat e punësimit, sapo më erdhi informacioni se në rang kombëtar në këtë moment janë 950 vende (*puna.gov.al*)...

(Diskutime pa mikrofon)

... i kam me listë. 950 oferta pune ... të njëjtën gjë po shohim moj zonjë...

(Diskutime pa mikrofon)

... presim minimumin e etikës kur komunikojmë me zyrtarët e shtetit...

Të dhënat e punësimit që ne kemi diskutuar në këtë komision edhe me drejtoreshën e INSTAT-it, edhe me ministrin e Financave.

Të dhënat e INSTAT-it të qeverisë unë nuk i marr bazë krahasimi. Kur thotë se është rritur punësimi në bujqësi dhe ka rënë rritja e prodhimit në bujqësi, është rritur një sektor dhe nga pikëpamja ekonomike dhe ka rënë punësimi në këtë sektor, domethënë INSTAT-i është duke manipuluar shifrat në atë nivel që as të vetat nuk po i korrelojnë dot.

Zoti Braçe ka të drejtë, se në qoftë në 4 vjetët e kaluara janë punësuar 300 mijë vetë, na sillni borderotë që t'i shohim. Në qoftë se një problem që vjen nga qytetarët është punësimi. Zyrat e punës janë totalisht infektive. Lërimi emocionet politike!

Erion Braçe – E ke shumë gabim...

Jorida Tabaku – Mos më ndërhyini! Janë totalisht inefektive. Nuk ofrohen vende pune për atë që ka nevojë tregu. Nuk ka një analizë se çfarë kërkon tregu dhe çfarë ka arsimi profesional. Kurrikulat i përmendët vetë, prandaj nuk po i përmend.

Filluat pak nga pak të manipuloni shifrat për të arritur te 300- mijëshi, por nuk ia arritët dhe ndaluat te 220-mijëshi për 4 vjetët e kaluara, sepse nuk doli llogaria.

Në qoftë se janë punësuar 300 mijë persona për 4 vjetët e kaluara, na sillni borderotë që t'i shohim!

Erion Braçe – Sfidë e madhe është. Po çfarë ndodh pastaj po erdhën borderotë? Vetëm do t'i këqyrësh?

Zonja Tabaku, që nga viti 2014 që bujqësia nuk ka njohur rënie si sektor. Kanë qenë brenda edhe pyjet dhe për shkak të moratoriumit për pyjet është afektuar pikërisht kjo. Ama, në qoftë se nuk e beson ende këtë gjë, shiko shifrat e eksporteve bujqësore. Meqë ju keni qejf t'i kryqëzoni të dhënat vazhdimisht, po jua përsëris edhe një herë, se shifrat e eksporteve bujqësore tregojnë se nuk ka rënie të prodhimeve bujqësore, por ka vetëm rritje nga viti në

vit. Ju keni plotësisht të drejtë kur flisni për sigurimet shoqërore në fshat. E kam thënë unë, e keni marrë ju më pas, po presim një zgjidhje dhe po ua them se ligji për sigurimet shoqërore në fshat nuk funksionon.

Në qoftë se kjo qeveri vonohet akoma më tepër për të dhënë një zgjidhje të ligjit të sigurimeve shoqërore për fshatin, po jua them unë, që bomba sociale për moshat e treta mbas 20, 30 apo 40 vjetësh natyrisht që do të jetë shumë e madhe në fshat ose ata njerëz do të vazhdojnë të punojnë edhe 70 vjeç te toka për të nxjerrë të ardhurat e domosdoshme për të jetuar.

E kemi diskutuar këtu në komision këtë çështje, ndaj s'është nevoja të më tregoni mua sigurimet shoqërore të fshatit. Ja, po ta them unë se nuk funksionon. Për dy ditë, tha zonja, do t'ua sjellë të kryqëzuara informacionet e sigurimeve shoqërore lidhur me vendet e punës.

Po e përsëris edhe një herë, në qoftë se ka një problem sot në fshat është pikërisht çështja e mosfunksionimit të ligjit për sigurimet shoqërore.

Njerëzi atje nuk kanë ose nuk janë të bindur për të paguar atë tarifë që është vendosur për sigurimet shoqërore dhe kjo ka krijuar këtë pasojë që ne do ta kemi pas 20, 30 apo 40 vjetësh.

Ky është një problem që duhet adresuar sa më shpejt të jetë e mundur, ndërkohë që po jua them se sot në bujqësi ka vende pune të lira dhe nuk ka njerëz që të shkojnë të punojnë, prandaj detyrohen të merren nga komuna të tjera me automjete dhe sillen për të punuar në bujqësi.

Përparim Spahiu – Për sa i takon punësimit kam një pyetje. Para disa kohësh ka të dhëna që numri i të punësuarve në administratë është 14 mijë më i madh se sa 2 vjet më parë, edhe pse kemi 4 ministri më pak. A është e vërtetë kjo? Këto janë të dhëna të INSTAT-it.

Erion Braçe – Po i referoheni administratës qendrore apo administratës që përfshin edhe pushtetin vendor?

Përparim Spahiu – Pushteti vendor nuk ka lidhje me administratën shtetërore.

Erion Braçe – Ka lidhje që ç'ke me të se shteti është unik.

Numri i të punësuarve në administratë...

Përparim Spahiu – Atëherë janë njerëz që paguhën nga buxheti i shtetit, 14 mijë më shumë dhe të mos e dijë Ministria e Financave dhe zonja, që paguhën 60-70 milionë euro më shumë në vit nga buxheti i shtetit, apo mos t'i kujtohen...

Jeni dakord ju?

Erion Braçe – Jo, unë nuk jam dakord fare me çfarë thoni ju. Ajo që po them unë është se numri i të punësuarve në administratën publike miratohet vit për vit në këtë komision dhe në atë parlament me miratimin e buxhetit të shtetit.

Tani më lejoni t’u them këtyre punonjësve të stafit të nxjerrin numrin që është miratuar në buxhetin e shtetit nga viti 2009 e këndej.

Jorida Tabaku – Nuk ka pse të bëhet një debat teknik mbi shifrat, por fakti është se INSTATI në mënyrë të përsëritur, ashtu siç i kam thënë edhe drejtoreshës së INSTAT-it kur ishte këtu, ka nxjerrë persona nga forca aktive e punës në bujqësi dhe më pas i ka rifutur në forcën aktive të punës në bujqësi duke i konsideruar si të punësuar.

Këtë ia kam treguar drejtoreshës së INSTA-it, edhe tabelat me shifra dhe ajo ktheu një përgjigje me shkrim. Meqenëse doli kjo praktika e përgjigjeve me shkrim, po jua vë edhe juve në dispozicion për të treguar që në sektorë të ndryshëm INSTAT-i ka manipuluar shifrat për të rritur në mënyrë fiktive numrin e të punësuarve. Pyetja ime është: të ardhurat e sigurimeve shoqërore, duke hequr ndryshimet që ka pasur efekti i taksave në sigurimet shoqërore, a kanë pasur rritje për të justifikuar 300 mijë persona në pesë vjetët e fundit, përveç tremujorit të parë apo gjashtëmujorit të parë që unë përmenda më pak sipër?

Faleminderit!

Erion Braçe – Patjetër! Do t’i ktheni përgjigje për dy ditë.

Ka pyetje të tjera?

Ka diskutime?

Atëherë kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S. p. A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 1. Kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 2. Kundër? Pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

E hedhim projektligjin për votim, në tërësi.

Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit, zonjë! Do të duhet që, deri ditën e premte, të ktheni përgjigje pranë këtij komisioni, lidhur më çfarë u pyetët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj, Edmond Spaho, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi dhe Pjerin Ndreu

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Reme Lala, Fatbardha Kadiu, Agron Shehaj.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ani Dymishi - Administrator në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bashkim Kasoruh - Njësia e Zbatimit të Projektit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Luljeta Dauti – përfaqësuese e Sektorit Arsimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ermir Omari - projekt menaxher i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Erion Braçe - Viojmë me projektligjin tjetër: “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore

Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”.

Zoti Shkreli, mund të afroheni!

Sa të ulet zotëria, mund të vazhdoni!

Relator i komisionit, lidhur me projektligjin është zoti Roland Xhelili.

Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ç’është kjo pyetje për procedurë, tani? Ose procedurë ose pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, zëvendësministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës.

Jorida Tabaku – Shoh se këtu, në listën e personave që kanë ardhur, është edhe zoti Ani Dyrmishi, administrator në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërkohë që me një *google search* të thjeshtë zotëria më doli në listën e 100 personave të korruptuar, të prezantuar nga zoti Rama. Kam një shqetësim tani: cilës listë t’i referohemi, listës së prezantimit që ka ardhur nga ministria apo listës që ka prezantuar Kryeministri, për personat e korruptuar? Këtë shqetësim, mendova ta ndaj edhe me ju.

Erion Braçe – Cili është zotëria? Ju jeni?

Jorida Tabaku – Këtë shqetësim kam. Duke e ditur se keni parime shumë të forta në luftën ndaj korrupsionit, shqetësimi im është: t’i besojmë Ramës, apo të mos i besojmë? Jua thashë pak më parë, keni hall të madh...

Erion Braçe – Kërkoni që zotëria të mos jetë në mbledhje?

Jorida Tabaku – Së pari, bazuar në informacionin që ka dhënë Kryeministri, do të kisha kërkuar të mos vinte fare si përfaqësues këtu, para parlamentit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – A jam edhe unë njeri i korruptuar? Edhe unë, në kohën e Kryeministrit Berisha kam qenë te lista e njerëzve të korruptuar. Si i bëhet?

Jorida Tabaku – Për mua standard është Berisha, por unë e di se keni idhull Ramën, ndaj po u referohem të dhënave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Me qetësi! A ka mundësi? Stop, njëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Për mua standard është Berisha, por unë e di se ju keni idhull Ramën, prandaj iu referova listës së Ramës. Standardeve tuaja iu referova.

Erion Braçe – Po, urdhëroni, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Kryetar, unë mendoj që, meqenëse kolegia, nënkryetarja, që në fillim, në krye të herës, kur mori fjalën, për të disatën herë më pas e përsëriti, na flet për standardet, për procedurat dhe për faktin se sot, më së fundi, po i rikthehemi normalitetit në këtë komision, do të thosha që këto batuta t'i lëmë jashtë këtij komisioni.

Besoj se këtu, në rastin konkret, ne nuk jemi në gjyq, sepse po të ishim, do t'i thoshit zotit Dyrmishi të ngrihej dhe të deklarohej nëse është i fajshëm apo i pafajshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë kishit ju? Jo ju, zotëria tjetër.

Artan Shkreli – Doja të thosha këtë: në qoftë se këtu do të flasim për gjëra teknike, financiare dhe legale, normalisht duhet të biem dakord në parim. Në qoftë se këtu do të flitet për insinuacione të natyrave nga më të ndryshmet, në kontekste që s'kanë lidhje me këtë mbledhje, kjo pastaj është muhabet kot. Edhe unë jam te listat e Partisë Demokratike si njeri i korruptuar apo si njeri me probleme politike, po them unë, por çfarë do të thotë kjo histori?

Në qoftë se fjalët që merren këtu kanë barazvlefshmëri legale, atëherë nuk jemi fare në një linjë. Kaq. Këtë desha të thosha.

Erion Braçe – Po, urdhëroni!

Jorida Tabaku – Në fakt, gjyqin nuk po jua bëjmë ne. Unë iu referova një liste të publikuar nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërprisni, se ju dëgjova!

Ju referova një liste të publikuar nga Kryeministri, thjesht për të treguar s kjo qeveri e ka çdo gjë fasadë. E nxori me të madhe në listën për luftën ndaj korrupsionit dhe e ripunësoi. Zotëria është vetëm një nga qindra të tjerë. Nuk e njoh fare zotërinë, nuk e di fare aktivitetin dhe pse e ka nxjerrë në listë, siç nuk e di fare se përse e ripunësoi.

Zoti Shkreli, në qoftë se keni diçka për të komentuar, unë besoj se është rasti të flasësh edhe për teatrin. Dole për kangjellat e Kryeministrit, ndërsa tani mendoj se ka ardhur dita që, si një adhures i trashëgimisë kulturore dhe i identitetit kombëtar, të dalësh e të flasësh për teatrin. Përdore edhe këtë komision, sepse ne këtu kemi folur gjatë për teatrin. Në qoftë se ke dëshirë, unë besoj se kryetari ta jep hapësirën që të flasësh për teatrin.

Erion Braçe – Me një kusht, me kushte.

Jorida Tabaku – Shqetësimi që unë ngrita në lidhje me zotërinë, jua them edhe një herë, e bazova në informacionin zyrtar të kësaj qeverie të Kryeministrit Rama. Me standardet e Berishës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk e di. S'e di. E keni publikuar ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk e di për çfarë e ka publikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Me qetësi, me qetësi!

Më falni! Nuk e akuzoj unë

Jorida Tabaku – Nuk e akuzoj unë. Unë iu referova një publikimi të Kryeministrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zonja Dhima, një sekondë, se po flet zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – A mund të bëj një sqarim? Të lutem, a mund të bëj një sqarim? E para e punës, duhet të edukoheni me konceptin e informacionit, edhe qeveria, edhe opozita. Keni bërë lëmsh dynjanë. Informacioni nuk është provë. Mund të nxjerrë informacione sa të dojë Kryeministri, çdo ministër, çdo pjesëtar i opozitës e më gjerë, por nuk përbën arsye për të njollosur njerëz, për t'i akuzuar. Tani meqë ka nxjerrë Kryeministri një listë, ai ka marrë disa impakte që nuk janë të vërtetuara, dhe për mua kjo ka qenë gabim. Është vërtetuar gabim. Ka pasur edhe raste flagrante aty. Ju keni lista e stërlista, akuza e stërakuza, ashtu siç tha zëvendësministri, por ne nuk do të merremi me këto tashti.

Informacionet nuk janë arsye për të baltosur njerëzit. Ju lutem shumë, vihuni në hullitë e ligjit, sepse keni derivuar dhe nuk dini çfarë thoni.

Erion Braçe – Të gjithë, të gjithë, jo vetëm zonja, të gjithë në hullinë e ligji, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Kryetar, këtu është një çudi shumë e madhe, një çudi e jashtëzakonshme. I referohemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I referohemi Kryeministrit, bëjmë gabim, i referohemi Partisë Demokratike, bëjmë gabim. Epo, bini dakord për një term!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjerin Ndreu – Vetëm Saliu dhe Luli juaj s'bëjnë gabime ë? Epo, çfarë janë këto?

Jorida Tabaku – Mua më vjen mirë që u pranua se Kryeministri bën gabime.

Pjerin Ndreu – Nuk është listë për të akuzuar njerëzit ajo. Ajo është vetëm informacion. Si i akuzon njerëzit vetëm me informacion

Jorida Tabaku – Po s'i akuzova unë, por Kryeministri.

Pjerin Ndreu – Po si e akuzon tjetrin me informacion? Ç'është kështu?

Jorida Tabaku – Po ju bëj thirrje si kryetar i komisionit, si luftëtar në luftën kundër korrupsionit. E ngrita këtë shqetësim, pikërisht bazuar në sensibilitetin tuaj dhe të anëtarëve socialistë në lidhje me këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka pse qeshin.

Erion Braçe – M'u drejtua mua. Ç'keni ju?

Jorida Tabaku – Unë sugjeroj që, për standardet e këtij komisioni, zotëria nuk mund të na japë dot sqarime, pa sqaruar publikisht se për çfarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të flas?

Erion Braçe – A ka mundësi të mbarojë zotëria? Pse irritoheni kaq shumë? Çfarë keni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbarojë zonja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, më fal!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po mirë, punë e madhe!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po avash, merr mikrofonin dhe fol! Të mbarojë zonja, njëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me qetësi, me qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Shiko, unë e kuptoj shumë mirë se ju, për të sulmuar të tjerët dhe për të mbrojtur atë, çfarë nuk mund të thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërhyj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më ndërhyj! Thuaji të mos më ndërhyjë, të lutem!

Erion Braçe – Ka të drejtë në këtë aspekt, por ju mund të vazhdoni.

Jorida Tabaku – Për çfarë aspekti?

Erion Braçe – Për atë që keni thënë për zotin Ndreu, por le të vazhdojmë tani.

Jorida Tabaku – Për zotin Ndreu s'kam folur ndonjëherë...

Erion Braçe – Partia jote, moj zonjë, partia jote. Seksioni i sigurimit në partinë tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ngrita një shqetësim, zoti Braçe, gjë për të cilën nuk ka pse të hidhen në sulm të gjithë kolegët socialistë, si dhe zonja, duke vazhduar me sulme personale, që unë s'i kam bërë kurrë për asnjë dhe as s'i kam menduar për asnjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Nuk bëri sulme personale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Unë iu referova një informacioni zyrtar të qeverisë. Njëkohësisht, i kërkoja zyrtarisht zotit Shkreli, që nëse do të flasë për diçka, le të flasë për teatrin.

Erion Braçe – Do më lini mua të bëj punën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Kështu që, nuk besoj se bëra diçka që nuk është bërë herë tjetër në këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Po më lini të bëj punën! Më lini të bëj punën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të bëj punën unë? A ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, nuk ka më leje tani.

Zonja Tabaku, meqë m'u drejtuat mua, së pari e mbi të gjitha duhet ta citoni mirë atë listë. Ajo është një listë e personave, për të cilët një mori qytetarësh kanë paraqitur pretendimet e tyre. Midis atyre emrave ka edhe emra shumë të nderuar, për të cilët ju jeni hedhur në zjarr, e në lidhje me të cilët unë ju kam dhënë shumë të drejtë. Kështu, pa asnjë lloj diskutimi, unë i bashkohem asaj që thotë zoti Ndreu, që në raport me ligjin duhet të kemi qasje komplet tjetër.

Në qoftë se një qytetar ka vërejtje për mua, për ju, për cilindo, është e drejta e qytetarit ta bëjë këtë. Ai që e publikon duhet të tregojë kujdes maksimal, që të mos e tejkalojë ligjin dhe të cenojë atë parim kushtetues, që besoj se edhe ju, edhe unë, e përkrahim deri në

fund: parimi i prezumimit të pafajësisë. Për më tepër, kur bëhet fjalë për ankesa të njerëzve; jo për denoncime, po për ankesa të njerëzve ndaj filan zyrtari. Ndërkohë, për çështjen tjetër më lejoni t'ju kujtoj se të gjithë të ftuarit që ndodhen këtu do të flasin vetëm për çështje që janë në rendin e ditës.

Në qoftë se ju doni të bëjmë politikë, unë mund t'ju lë një seancë të posaçme, pa asnjë lloj problemi, që ju, zoti Shkreli dhe unë të flasim për teatrin sa të doni, por ama me kushtin që zoti Shkreli, me atë cilësi që e veçuat ju, të flasë edhe për trashëgiminë kulturore të SHQUP-it, edhe për trashëgiminë kulturore të Sarajeve, që janë mu ngjitur me godinën e Teatrit Kombëtar, për vendimet që janë marrë në kohë të ndryshme në institucionet e shtetit, po natyrisht edhe për përfituesit e tyre.

Zoti zëvendësministër, keni fjalën, për të prezantuar projektligjin në fjalë!

Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e ka zëvendësministri Erjon Luçi, që do të flasë për këtë pjesë. në rast se ju keni diçka për të plotësuar nga pikëpamja teknike për çështjen e hekurudhës, pa asnjë lloj dyshimi do ta merrni fjalën.

Urdhëroni, zoti Luçi!

Erjon Luçi – Faleminderit, zoti kryetar! Do t'ju kërkoja mirëkuptim edhe për eficiencë kohore, që të kuptonim e ky është një ligj që ka kaluar më parë në këtë komision e në parlament. Pra, nuk po flasim për asgjë të re; është thjesht pjesa e grantit që i shtohet një projekti, i cili është i prezantuar, i kaluar dhe i diskutuar.

Nëse doni, mund të hyjmë prapë në detaje teknike, por nuk ka asnjë ndryshim nga projekti origjinal, që ka ardhur më parë, në lidhje me kredinë e BERZH-it. Tashti thjesht i shtohet pjesa e grantit, dhe mund të themi se është një miks model, një nga më të mirët, që është një euro hua për një euro grant. Domethënë, është thjesht pjesa financiare, të cilën po e plotësojmë. Do të theksoja se është projekt jashtëzakonisht i mirë për të rritur konektivitetin. Gjithsesi, nuk doja të hyja në detaje që janë dhënë disa herë në këtë komision e në parlament.

Ju falënderoj!

Erion Braçe – Faleminderit juve!

Zoti Shkreli, fjala për ju!

Artan Shkreli – Unë doja vetëm të theksoja faktin se këtu bëhet fjalë vetëm për një pjesë të financimit të kësaj hekurudhe. Relatori do ta ketë thënë më përpara, por këtu bëhet fjalë për grantin që ka dhënë WIB-ja nëpërmjet BERZH-it, që filtrohet përmes Bankës Botërore për Zhvillim.

Natyrisht, për sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me aspektet teknike e juridike të kësaj gjëje, pavarësisht se është thënë e rithënë, jemi në dispozicion për të dhënë edhe shpjegime me karakter teknik, pavarësisht se këtu flasim për pjesën ekonomike.

Erion Braçe – Në rregull! Faleminderit!

Zoti Xhelili.

Roland Xhelili – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe zëvendësministrave, të cilët më dhanë mundësinë ta trajtoj pak më gjerë.

Ky është projektligj i miratuar në parim, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 23. 2. 2018, si dhe i nënshkruar ndërmjet palëve më 9 maj, “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”

Gjithashtu, kjo marrëveshje synon zbatimin e projektit të detajuar, të hartuar në bazë të marrëveshjes së grantit, të datës 13 mars 2015. Granti është në shumën 35, 4 milionë eurosh dhe do të përdoret për financimin e punimeve për rehabilitimin e linjës ekzistuese dhe ndërtimin e linjës së re, në kuadër të projektit, shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve dhe mbështetjen e zbatimit të projektit.

Zërat e financuara nga granti janë si më poshtë:

Kontrata për punime për rehabilitimin e linjës Durrës – Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore për në aeroport do të financohet në masën 32, 9 milionë euro.

Shërbimet e mbikëqyrjes së punimeve do të financohen në masën 1, 5 milionë euro.

Zbatimi dhe mbështetja për njësinë zbatuese është në masën 1 milion euro.

Është e rëndësishme të theksohet e ky projekt do të përfundojë më 31 dhjetor 2020. Objektivat kryesorë lidhen me rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore nga stacioni qendror hekurudhor i Durrësit e deri në vendndodhjen e ardhshme të terminalit të transporteve publike në Tiranë, me nj gjatësi prej 34, 2 kilometra; gjithashtu për të ndërtuar një linjë të re hekurudhore, e cila do të lidhë linjën kryesore me aeroportin e Rinasit, me një gjatësi prej 4, 7 kilometra, duke përfshirë edhe degëzimet shtesë, për të lidhur respektivisht linjën e re me terminalin e transportit publik Tiranë, si dhe me qytetin e Durrësit.

Gjithashtu, projekti parashikon ndërtimin e një terminali hekurudhor në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës, si dhe instalimin e një sistemi të ri sinjalizues të telekomunikacionit, të integruar në sistemin e linjës hekurudhore Durrës – Tiranë – Rinas.

Zbatimi i këtij projekti do të bëhet nga Hekurudha shqiptare sh. a, në cilësinë e njësisë së projektit, dhe do të mbështetet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Dua të theksoj se kjo linjë është pjesë e projektit ballkanik “Rruga 2”, e cila përfshin drejtimin Podgoricë, Mali i Zi – Tiranë – Durrës, Shqipëri. Mbas këtij projekti, i cili përcakton realisht fillimin e zbatimit konkret të ndërtimit të hekurudhës Durrës – Tiranë – Aeroporti i Rinasit, do të vazhdojë edhe projektimi, madje ka filluar, i linjës 120 kilometra të gjatë: Vorë – Hani i Hotit, kufi, që do të bëjë lidhjen e sistemit hekurudhor shqiptar me sistemin hekurudhor evropian.

Në fund, duke qenë se kjo marrëveshje do të ndihmojë në përmirësimin e sistemit hekurudhor të vendit tonë, duke siguruar një vlerësim të plotë financiar dhe ekonomik, do të lejojë investime të mëtejshme në hekurudhë për periudha afatmesme e afatgjata, i propozoj komisionit, dhe kam besim, që ta miratojmë të gjithë së bashku.

Faleminderit!

Erion Braçe – Ka pyetje? Po, zoti Haxhinasto, urdhëroni!

Edmond Haxhinasto – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, kam tre pyetje. Pyetja e parë është: A e ka gati pjesën e vet shteti shqiptar, e ka planifikuar? Nëse jo, kur do ta planifikojë pjesën që do të investojë për këtë projekt?

Pyetja e dytë: Studimi i detajuar është respektuar në gjurmën që ka parashikuar ai, apo ka ndryshime të gjurmës së parashikuar në studimin e detajuar?

Pyetja e tretë: Një element shtesë i studimit të detajuar ka qenë lidhja me Tiranën, pra një lidhje përtej terminalit të transportit publik, por një lidhje me qytetin e Tiranës. A është parashikuar kjo apo jo?

Faleminderit!

Erion Braçe – Po, urdhëroni!

Erjon Luçi – Është detyrim që pjesa e shtetit të parashikohet, përveç të tjerave, për koston lokale. Në relacion është e qartësuar pjesa e shtetit shqiptar, në lidhje me TVSH-në dhe koston lokale, por është kryesisht TVSH. Për pyetjen e tretë, përgjigja është po, sapo është çuar përsëri kërkesa për t’u përfshirë edhe lidhja me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Të dëgjojmë pak, ju lutem, se nuk po kuptojmë asgjë!

Zoti Xhakolli, të dëgjojmë pak!

Erjon Luçi- ...që do të vijë shumë shpejt, kështu që do të jetë një pjesë e buxhetit...

Edmond Haxhinasto – Më fal, zoti zëvendësministër! Është për buxhetin e 2018-ës apo të 2019-ës?

Erjon Luçi – E 2019-ës.

Edmond Haxhinasto –E 2019-ës.

Erjon Luçi – Edhe sikur të fillojë, është shumë herët. Sa i takon së tretës, lidhja me stacionin e Tiranës është përfshirë në studim. Është çuar një kërkesë për një miks tjetër granti me hua, pikërisht për të bërë edhe pjesën e stacionit, që së shpejti do të vijë këtu, për ta diskutuar.

Artan Shkreli – Sa i përket pikës së dytë, gjurma e projektit nuk është ndryshuar. Do të zhvillohet po aty ku është miratuar që në fillim. Këtu gjej rastin, edhe nga pikëpamja profesionale, për ta përshëndetur edhe një herë lidhjen me terminalin e vjetër të Tiranës, i cili është parashikuar në projekt nga administrata paraardhëse dhe do të bëhet pikërisht ashtu siç ishte parashikuar. Megjithatë, nuk bën pjesë në këtë buxhetim.

Projekti ekzekutiv po bëhet tani për bashkimin e intermodalit, po themi, të “Casa Italia”-s me ish-stacionin e vjetër të trenit, i cili do të vijë po aty ku ka qenë. Po mbaron parkimi nëntokësor. Domethënë, kur e shikon stacionin përballë, në krahun e majtë, do të bëhet terminali i Tiranës, i cili do të jetë me *light trail* të rregullt, nuk do të jetë me trenin e zakonshëm, në mënyrë që ky tren të përdoret pastaj edhe nga pasagjerët për të shkuar në Rinas, që nuk do të jetë linja klasike.

Bëhet një fjalë për një financim të ri, që do të jetë ky që, nga masat paraprake, duhet të jetë rreth 12 milionë dollarë, por ky do të parashikohet kur të bëhet buxheti për vitin tjetër.

Për sa i përket pyetjes së parë, nëse mund të shtoj diçka të vogël, te pjesa e buxhetit të shtetit të parashikuar për vitin 2019 hyjnë edhe fondet për shpronësimin për linjën e re, e cila nuk ekziston sot si trase, që është nga Domja në Rinas. Kjo është traseja e re që parashikohet të ketë edhe shpronësime e të gjitha gjërat me radhë. Natyrisht, kjo është parashikuar në buxhet për vitin 2019 nga ana e ministrisë sonë.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur mund të bëhet efektive, pra të fillojë puna?

Artan Shkreli – Në datën...

Erion Braçe – Sepse është i disati vit që e bëjmë këtë pyetje.

Artan Shkreli – Ekzakt.

Tani jemi në fazën ku është bërë paraseleksionimi dhe fituesi duhet të shpallet në fund të shtatorit, sipas skedulit që kemi. Kështu që punimet fillojnë në ditët e para të janarit, që do të zgjasin dy vjet, deri në fund të vitit 2020.

Erion Braçe – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Tabaku!

Jorida Tabaku – Së pari, mua më vjen mirë që ne kemi një projekt për hekurudhën, pasi gjithmonë ka qenë shumë e vështirë të angazhoje fonde, të paktën ndërkombëtarësh, për hekurudhën.

Shpresoj shumë që personat e përfshirë, duke pasur parasysh edhe akuzat për korrupsion nga vetë kreu i qeverisë, të tregojnë integritet në menaxhimin e këtij fondi dhe shpresoj shumë që ky projekt të mos na përfundojë me kulla, si rasti i Teatrit.

Në këtë rast dua të ngre dy shqetësime, njëri që ka lidhje me këtë dhe tjetri me zëvendësministrin Shkreli, i cili, në fakt, vjen në komision për herë të dytë, nuk ka pasur mundësi ta bëjë më parë, por besoj se e përdor komisionin dhe nuk ka shqetësim nga ana e kolegëve socialistë.

Shqetësimi i parë lidhet me projektet e partneritetit publik-privat dhe ofertat e pakërkua. Nga projekti “1 miliard”, nga të cilat katër projekte deri tani kanë përfunduar dhe janë tenderuar, në mos gaboj, tre duhet të jenë nga ministria juaj, sepse ishin projekte rrugësh, janë me oferta të pakërkua. A ka oferta të tjera të pakërkua në ministrinë tuaj qoftë për projektin “1 miliard”, qoftë për projekte të tjera në infrastrukturë apo edhe në fusha të tjera?

Erion Braçe – Zonja Tabaku, pyetja që ju po adresoni nuk ka lidhje me ligjin...

(Deputetja Tabaku flet pa mikrofon.)

Mirë pra, tani, se edhe pak më herët zonjës zëvendësministre i kërkuat disa të dhëna që nuk i kishte dhe, natyrisht, për shkaqe nga më të ndryshmet edhe ne, edhe ju, nuk merrni përgjigje, edhe zonja ndihet keq që nuk jep përgjigje e të tjera me radhë, edhe zotëria këtu ka ardhur për një çështje të caktuar.

Në qoftë se ju doni të flasim për projektet me partneritet publik-privat në infrastrukturë, pa asnjë lloj diskutimi, mund të thërrasim jo zotin Shkreli, por ministrin të vijë këtu dhe t’u përgjigjet pyetjeve që ju keni për këtë gjë.

Por tani, unë shqyrtoj që të pashë, hajde të të bëj një pyetje dhe të të kap gafil ty, kjo nuk i shërben mbledhjes, me thënë të drejtën, sepse as zotëria mund të mos jetë i gatshëm t’ju japë përgjigje, as ju nuk merrni përgjigjen që dëshironi për këtë çështje të caktuar.

Unë nuk e di nëse zotëria është ose jo i gatshëm t'ju përgjigjet, por, me thënë të drejtën, edhe mua të ma kishit bërë këtë pyetje, nuk do t'ju përgjigjesha, sepse nuk e kam informacionin e caktuar përpara për t'ju dhënë përgjigjen që ju kërkonit për këtë gjë.

Nuk e di nëse zotëria është gati, por...

Jorida Tabaku – Pyetja e parë lidhej me faktin se si 60 mijë të punësuar ishin reflektuar në të ardhurat e sigurimeve shoqërore.

Ndërsa pyetja këtu...

Erion Braçe – Patjetër pra.

Jorida Tabaku – Ndoshta...

Erion Braçe – Kjo gjë, për të cilën ju pyetet kërkonte të dhënat e sigurimeve shoqërore...

Jorida Tabaku – Dakord pra, nuk po...

Erion Braçe – Ndërkohë, zonja kishte ardhur të fliste për kredinë...

Jorida Tabaku – Kishte ardhur të fliste për arsimin profesional në lidhje me punësimin.

Erion Braçe – ...dhe nuk i kishte të dhënat me vete, sepse të dhënat e sigurimeve shoqërore nuk janë online. Të ishin online, do të përgjigjej, siç t'u përgjigj për shifrat...

Jorida Tabaku – Këtu bëhet fjalë për projektet 200, 300 milionë që zëvendësministri edhe mund t'i dijë, por po flasim për dy gjëra të ndryshme.

Erion Braçe – Mirë pra, tani!

Edhe një herë...

Jorida Tabaku – Në qoftë se zëvendësministri ka nevojë për kohë dhe të marrë informacion, sigurisht, por lëreni të përgjigjet vetë.

Erion Braçe – Por kjo nuk ka lidhje për arsyen pse jemi mbledhur, zonja Tabaku. Ju e kuptoni fare mirë që unë kam interes shumë më tepër sesa ju për këtë çështje, por nuk ka lidhje me këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje me çështjen për të cilën kanë ardhur.

Unë mendoj se ky projekt infrastrukturor është aq i mirë, sa edhe ju e vlerësoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë them të rrimë te ky projekti.

Në qoftë se ju keni vërejtje esenciale për projektet e tjera, pa asnjë lloj diskutimi, biem dakord bashkë që, ju, si nënkryetare, dhe unë, si kryetar, të caktojmë një ditë të caktuar,

ta thërrasim ministrin respektiv, të vijë këtu dhe të japë sqarime për projektet me partneritet publik-privat në fushën e infrastrukturës. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju kërkoj një gjë krejt normale...

(Deputetja Tabaku flet pa mikrofon.)

Mund të mos ketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Keni informacion për këtë gjë, zotëri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, çfarë të them unë?!

Artan Shkreli – Atëherë, këtu janë dy gjëra: ose do të djegim pyetjen, duke dhënë informacione të paplota si rezultat i papërgatitshmërisë sonë për t’iu përgjigjur një gjëje të tillë: a ka projekte të tjera, çfarë projektesh janë, se këtu hapet pastaj komplet një histori tjetër, që mund të jetë shumë e rëndësishme, por nuk është objekt i kësaj tematike, patjetër që ka oferta të pakërkuara. Ato shqyrtohen nga komisione të veçanta, shpeshherë edhe me konsulentë të huaj, të cilët janë shumë të kujdesshëm se çfarë po ndodh me programin “1 miliard”, një pjesë e të cilave janë për t’u paraqitur dhe një pjesë e të cilave skartohen. Po them vetëm diçka: qeveria shqiptare ka kërkuar shumë oferta të pakërkuara, edhe për të bërë dy porte jahtesh turistike dhe nuk vijnë, se ka edhe gjëra për të cilat mungon ekspertiza, mungojnë paratë, mungon interesi në fushën përkatëse e të tjerë.

Për sa u përket rrugëve, interesi ka qenë më i madh, sepse ka shumë firma shqiptare, të cilat janë specializuar gjatë këtyre viteve. Ky është motivi. Por fusha, gama e hapjes së partneritetit publik-privat është shumë më tepër e gjerë sesa autostradat apo edhe punë të tjera publike.

Në qoftë se ju doni, ne mund të lëmë një takim tjetër dhe flasim për këtë temë, pra vijmë të përgatitur, dhe t’u kthejmë përgjigje të gjitha pyetjeve që keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Hedhim në votë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe

ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nën për nën.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, Dashamir Shehi dhe Pjerin Ndreu.

Mungon:

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Reme Lala, Fatbardha Kadiu dhe Agron Shehaj.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Ermir Omari – Menaxher projektesh pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Erion Braçe – Kalojmë te projektligji i fundit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shkreli, nuk keni lidhje ju me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale.

Erjon Luçi – Këto i kemi bërë me Fondin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Në rregull.

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Zëvendësministër!

Erjon Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e thatë, ky projekt do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe është vazhdim i një projekti po aq të suksesshëm që ka qenë për rrugët rurale me një masë më të madhe, rreth 400 milionë dollarë, të përfunduar me shumë sukses në aspektin e plotësimit të një *gap*-i shumë të madh, që ka pasur lidhja e akseve kryesore me zonat e banuara. Ai projekt e mbylli jo pak *gap*-in, që ishte gati nga zero, domethënë në 3500 kilometra të rrugëve rurale, por përsëri nevojat mbeten të larta. Kjo kredi vjen pikërisht në vazhdim të përpjekjeve për të përmirësuar aksesin që kanë zona të ndryshme të Shqipërisë drejt akseve kryesore dhe konsiston në një kredi prej 50 milionë dollarësh, e cila mund të zgjerohet edhe më tej edhe me kredi të BERZH-it, të po së njëjtës natyrë.

Përtej natyrës së ngjashme me kreditë e mëparshme ose me projektin e mëparshëm të rrugëve rurale, këtu ka një komponent tjetër, ku rreth 95% e kredisë është pikërisht për investime në përmirësimin e rrugëve rurale dhe me standarde të mira në aspektin e vijëzimeve, të sinjalistikës apo edhe vendeve për kalimin e biçikletave, pra është pak më i avancuar sesa projektet e kaluara. Ka edhe një element *soft* që, pavarësisht shqetësimit shumë të drejtë të ngritur shpeshherë për pjesën e asistencës teknike të dhënë për këto projekte, në këtë rast është me të vërtetë i rëndësishëm si komponent ngritja e kapaciteteve, sidomos e qeverive lokale, në përmirësimin e menaxhimit të aseteve të tyre. Domethënë, edhe qeveritë lokale tani kanë asete jo të vogla në rrugë, të cilat do të duan një planifikim dhe menaxhim më të mirë për sa i përket mirëmbajtjes në kohë, përpara se të jetë shumë vonë në aspektin e mirëmbajtjes.

Kështu që, një komponent jo shumë i madh, por i mjaftueshëm për të dhënë një rritje kapacitetesh në nivelin lokal së bashku me Fondin e Zhvillimit Rajonal është përfshirë edhe në këtë projekt, pra po lëvizim përtej një investimi që mund të bëhet edhe thjesht me fonde buxhetore, madje është bërë edhe në disa aspekte me fonde buxhetore, për të përmirësuar mënyrën e mirëmbajtjes së këtyre aseteve të rëndësishme për qeveritë lokale dhe për komunitetet përkatëse.

Si rezultat, do të theksoja që ky projekt synon të lidhë rajonet me rreth 80 mijë banorë, që për masën e kredisë është përsëri një *outcome* i mirë.

Për më shumë detaje kemi edhe kolegët e FSHZH-së këtu, por dua të theksoj se është bërë studimi se si do të bëhet përzgjedhja e këtyre rrugëve, por lista për këto rrugë do të jetë pjesë e buxhetit pasardhës, pra do të kemi mundësi ta diskutojmë brenda buxhetit të FSHZH-së në momentin kur ai do të miratohet. Domethënë, qëllim i këtij miratimi nuk është lista, sesa pjesa e kriterëve, të cilat janë të përcaktuara dhe janë kriterë bazike, sociale dhe potenciale ekonomike që kanë zona të ndryshme që mund të përzgjedhjen, edhe në kombinim me programin “100 fshatra”, që është një nismë e cila do të ketë lidhje edhe me mënyrën e përzgjedhjes së disa prej këtyre projekteve.

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për shpjegimet që dhatë!

Atëherë, projektligji “Për ratifikimin e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale” është një propozim i Këshillit të Ministrave dhe ne, si Komisioni i Ekonomisë, e shqyrtojmë atë në rolin e komisionit përgjegjës.

Shqyrtimi i këtij projektligji bazohet në nenin 121 të Kushtetutës dhe vjen sipas procedurave të parashikuara nga nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji parashikon që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë të marrë hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim një shumë prej 50 milionë dollarësh, e cila do të përdoret për financimin e projektit të konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale.

Ky projekt ka për qëllim të përmirësojë aksesin drejt qendrave të përzgjedhura agrobujqësore dhe të turizmit, si dhe të forcojë kapacitetet e bashkive të këtyre qendrave në menaxhimin e aseteve rrugore.

Projekti është i ndarë në tri pjesë, të cilat kanë si objekt rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale dhe përmirësimin e sigurisë rrugore në zonat e përzgjedhura; ngritjen e kapaciteteve të bashkive të përzgjedhura për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore, si dhe për të zbatuar programet e zhvillimit rural; mbështetjen për menaxhimin e projektit, ku vend të rëndësishëm zë mbajtja e një sistemi të informacionit gjeografik (GIS) dhe përdorimi i një databaze për prioritizimin e rrugëve rajonale dhe rurale.

Zbatimi i këtij projekti pritet të sjellë rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale, duke përmirësuar cilësinë dhe rritur sigurinë në rrjetin rrugor dhe në zonat rurale turistike; përmirësimin e qëndrueshmërisë së rrjetit rrugor; forcimin e kapaciteteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe të bashkive në zonat e projektit për të menaxhuar projektet e ndërtimit të aseteve rrugore.

Termet financiare të huas

Huaja ka një interes të bazuar në normën e referencës, plus marzhet e pandryshueshme. Tarifa e parapagimit është 0,25% e shumës së huas; tarifa e angazhimit është 0,25% e shumë së huas së padisbursuar, si dhe maturimi është 29,5 vjet, duke përfshirë periudhën prej 6 vjetësh pa pagesë principali.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje huaje është data 31 dhjetor i vitit 2022.

Projekti i parashikuar në këtë marrëveshje është pjesë e parashikimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Në lidhje me vlerësimin për këtë projektligj, marrëveshja që propozohet të ratifikohet është e rëndësishme, pasi do të sjellë përmirësimin e rrjetit rrugor lidhës me zonat rurale dhe ato me potencial turistik, duke ndihmuar në lehtësimin e lëvizjes së popullsisë dhe të qarkullimit të mallrave apo produkteve bujqësore turistike.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe të turizmit në vendin tonë, të cilat janë edhe fushat kryesore prioritare të programit qeveritar dhe të strategjive afatmesme të zhvillimit të vendit.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, i propozoj komisionit ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka zotëria.

Përparim Spahiu – Faleminderit!

Zoti Zëvendësministër, nga dje dhe sot, ne kemi kaluar dje 11 milionë euro, ndërsa sot 55 milionë euro, rreth 70 milionë euro kredi. Pyetja ime është: a mos duhet t'i rrisim edhe më shumë taksat, sidomos atë të qarkullimit, të rrisim çmimin e naftës, pasi fondet që ne përfitojmë nga taksat duken të pamjaftueshme?

Unë i referohem edhe qarkut të Dibrës, ku e gjithë mirëmbajtja e rrugës nacionale është dhënë me kredi të Bankës Botërore. Ajo menaxhohet nga një kompani private, pra nuk është nga buxheti i shtetit.

Për sa u përket rrugëve rurale, shpresoj që zoti Omari të japë ndonjë referim për zonën se ku parashikohen të shkojnë këto fonde. Thjesht ideja që në dy ditë ne kalojmë 70 milionë euro kredi, kjo e sotmja është për tridhjetë vjetët e ardhshëm, them se ndoshta duhet të shkojmë më tej me rritjen e taksave, që ne t'i paguajmë që sot dhe t'i parashikojmë në buxhet, ashtu siç thotë kryetari, që çdo fundviti që bëhet buxheti i shtetit, të kujdesemi edhe për rrugët, edhe për infrastrukturën në bujqësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Urdhëroni!

Erjon Luçi – Të gjitha kreditë që merren janë në përputhje të plotë me kuadrin makroekonomik, që synon uljen e borxhit. Domethënë, pavarësisht lidhjes me projekte të caktuara, parametrat e borxhit, të cilat do t'i diskutojmë shumë shpejt (pas gushtit) këtu, janë pikënisja për të ecur përpara.

Nëse ka...

Përparim Spahiu – Më falni, por ne po marrim borxh, po e rrisim borxhin.

Erjon Luçi – Nuk po e rrisim...

Përparim Spahiu – Prandaj po them unë që të rrisim taksat që ne t'i paguajmë direkt, të mos kemi borxhe.

Erjon Luçi – Ne jemi me primarë pozitiv, që i bie se borxhi po ulet, jo se po rritet, flas në aspektin e asaj që ne paguajmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë financime relativisht me terma shumë të mirë në krahasim me pjesën tjetër të borxhit që ti do të marrësh edhe nga tregu i brendshëm, edhe nga tregu i jashtëm, që janë me terma komercialë. Domethënë, vetëm gjatë vitit ne rinovojmë një pjesë shumë të madhe, gati 30% të PBB-së së borxhit. Ky mund të quhet një rifinancim i atij borxhi edhe për tridhjetë vjetët e ardhshëm për një projekt relativisht të mirë, që përmirëson profilin e borxhit.

Të gjithë këta 70-milionësha e të tjerë, me termat që shikoni aty, janë vërtet shumë xheneroze në aspektin e risqeve të ulëta që i sjell borxhi.

Përparim Spahiu – Dakord, me terma shumë të mirë ne e çojmë borxhin 100%. Pse shqetësohemi, atëherë?!

Erjon Luçi – Sepse të njëjtat...

Përparim Spahiu – Nuk më bind ideja që marrja e një kredie e ul borxhin.

Erjon Luçi – Të njëjtat organizata...

Përparim Spahiu – Tani, të lutem!

Ne marrim borxh, por ne nuk mundemi ta menaxhojmë Rrugën e Kombit, ndërkohë që taksa e rrugës merret. Ku shkojnë këto para? Këtë nuk po e kuptojmë, përveç rilindjes urbane!

Erjon Luçi – Të njëjtat organizata që i japin këto borxhe, kërkojnë edhe një konsolidim të qartë buxhetor të borxhit. Prandaj është ajo...

Përparim Spahiu – Po pra, se kemi FMN-në që na thotë se është 71,9, nuk ka rënë fare, madje kemi paguar edhe konsulencë! Në maj pati një konsulencë kompanie prej 1 milion eurosh, konsulencë për një foto të Kryeministrit me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai nuk është faji juaj, e kupton?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se nuk po shohim rënie të borxhit tani.

Rënie borxhi, marrje borxhi, nuk e di, personalisht nuk jam i qartë me përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – A mund të bëj një sqarim?

Në ligjin buxhetor vjetor të buxhetit të shtetit është e parashikuar huamarrja. Unë besoj se deri tani jemi brenda kufijve të ligjit buxhetor të huamarrjes.

Në ligjin e buxhetit të këtij viti huamarrja është parashikuar e tillë, në ato parametra, sepse, së pari, ruan të gjitha angazhimet që janë marrë në programin afatmesëm buxhetor dhe, natyrisht, edhe uljen e borxhit me aq pikë përqindje sa është parashikuar në ligjin buxhetor.

Pa diskutim që në momentin kur kalohet huamarrja, që është përcaktuar në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin 2018, borxhi rritet, apo jo? Ndërsa, në momentin që është brenda atyre parametrave, jemi në trajektoren rënëse të borxhit të parashikuar nga ligji i buxhetit për vitin 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përparim Spahiu – Edhe një ndërhyrje, se ju keni këtë skemën që këto PPP-të nuk i quani borxhe, ndërsa ne e kemi ndryshe. Them se jo vetëm është kaluar ajo që është në buxhet, por është shumë më e madhe.

Erion Braçe – Në buxhetin e shtetit për vitin 2018, kam përshtypjen se parashikimet janë ligjore, jo sipas meje dhe dikujt tjetër, por janë parashikime ligjore. Ekzaktësisht në këtë ligj është bërë parashikimi për shumat e partneritetit publik-privat, që përfshihet brenda vitit buxhetor. Këtë mund ta konfirmojë zëvendësministri. Deri tani, pra deri në fund të muajit qershor, çdo gjë në planin e partneritetit publik-privat është në parametrat e parashikuara nga ligji për buxhetin e shtetit për vitin 2018.

Jorida Tabaku – Kam përshtypjen se zoti Spahiu i referohej pikërisht faktit, që të keni vetëm angazhimin vjetor dhe jo detyrimet që kanë lindur nga të gjitha kontratat e reja, që janë bërë. Në emër të opozitës unë kam bërë një amendament për këtë çështje.

Erion Braçe – Një moment zonja Tabaku! Në rast se ka një kontratë 13-vjeçare, vit për vit planifikohet në buxhetin e shtetit detyrimi vjetor.

Jorida Tabaku – Po ky borxh si është llogaritur?

Erion Braçe – Njësoj.

Jorida Tabaku – Nuk është llogaritur...

Erion Braçe – Një sekondë!

A ka mundësi?

Edhe një herë, unë s'kam mundësi të planifikoj brenda një viti buxhetor kontratën 13-14-20-25 vjeçare me detyrimet e saj. Kaq.

Jorida Tabaku – Për shpenzimet jo, por si pjesë e detyrimit dhe angazhimit po. Kam një pyetje për zëvendësministrin.

Së pari, më vjen mirë që kemi njerëz profesionistë në komision. Zoti Luçi, ju falënderoj edhe për sqarimet konstruktive, ndryshe nga shumë përfaqësues të tjerë të qeverisë që na vijnë këtu!

Shqetësimi im është për asistencën teknike dhe kostot operative. Në një hua 50-milionëshe, në tabelën e fundit, keni bërë një ndarje: 2,85 milionë janë caktuar për konsulencë dhe 2 milionë janë caktuar për kostot operative dhe trajnimin.

Shqetësimi im i vazhdueshëm, që e kam pasur, e kam dhe do të vazhdoj ta kem, është se 10% për asistencë teknike dhe 10% për konsulencë është një shifër shumë e lartë për një kredi, aq më shumë, kur kjo është kredi. Këtu në marrëveshje, te aktivitetet, sqaroni se do të ketë trajnime, ngritje kapacitetesh për hartimin e projekteve e kështu me radhë.

Unë besoj se kushdo që merret me zyra projektesh dhe aq më shumë FSHZH-ja i ka kaluar fazat e ngritjes së kapaciteteve me këtë sasi fondesh dhe me këtë masë fondesh. Mua më duket e tepruar që 10% e kredisë të shkojë në drejtim të asistencës teknike, së pari.

Së dyti, a ka ndonjë informacion (ju kërkohet ndjesë nëse e keni thënë dhe më ka shpëtuar), se cilat do të jenë zonat gjeografike në të cilat do të përdoret kjo kredi, apo do të jetë subjekt i vendimit të FSHZH-së, Këshillit të Zhvillimit Rajonal, Komitetit të Zhvillimit Rajonal e kështu me radhë?

Erjon Braçe - Fjala për ju, zoti Luçi, me të gjitha vlerësimet!

Erjon Luçi – Ne mbajmë parasysh edhe shqetësimin e komisionit dhe e kemi rregull të pashkruar, që ta mbajmë këtë poshtë 5-10-përqindëshit. Kostoja operative është brenda normave normale.

Pjesa tjetër që desha të theksoj dhe u mundova ta shpjegoj në fillim, është se ky projekt do të lëvizë pak pjesën e të menduarit apo të trajtimit të rrugëve rurale. Nuk është thjesht një investim, por është thjesht për të rritur kapacitetin e *asset management*, që ne e kemi edhe në nivel kombëtar si sfidë. Pavarësisht përmirësimit me kalimin e kohës, kapacitetet lokale, sidomos ato të FSHZH-së kanë një *gap* kapacitetesh, për sa i përket mirëplanifikimit dhe mirëmenaxhimit të këtyre aseteve.

Megjithatë, do t'ia jepja fjalën e dhe kolegut nga FSHZH-ja për të shpjeguar disa detaje nga aspektet e asistencës se ku do të shkojnë aktivitetet dhe studimi, që është bërë për zonat ku pritet të shtrihet ky investim.

Përsëri do të theksoja se është elementi i dytë, ku do të keni mundësinë për të parë listën e plotë të investimeve, që do të jetë momenti i buxhetit të vitit të ardhshëm.

Ermir Omari – Përshëndetje, zoti kryetar!

Unë jam drejtori i projektit nga FSHZH.

Erion Braçe – Më falni!

Keni bërë shumë mirë që keni ardhur. Po drejtori juaj e ka pasur të pamundur të paraqitej në parlament?

Ermir Omari – Ai ju kërkon ndjesë.

Erion Braçe – Faleminderit për ndjesën, por herë tjetër duhet të vijë në komision!

Ermir Omari – Ai ka pasur një impenjim të minutës së fundit me Kryeministrin.

Erion Braçe – Me kë?

Ermir Omari – Me Kryeministrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zonja pyet, nëse ju jeni te ajo listë?

Ermir Omari – Jo.

Erion Braçe – Dakord, vazhdoni!

Ermir Omari – Lidhur me dy komponentët e asistencës teknike dhe kostot operative, këta janë komponentë të ndarë. Kur themi asistencë teknike vlera që parashikohet të marrëveshja është një vlerë, e cila përfshin supervizionin e punimeve, një pjesë për projektimin e rrugëve që do të investohen, si dhe (për herë të parë në këtë marrëveshje), përfshihet edhe një komponent tjetër, i cili synon të rrisë kapacitetet dhe sigurinë teknike të rrugëve. Meqenëse deri tani standardet e aplikuara të rrugëve dhe standardet e sigurisë kanë qenë shumë të ulëta, ky është një projekt pilot, i cili përfshin, gjithashtu në këtë komponent rritjen, evidentimin dhe përmirësimin ose krijimin e një zone pilot me standarde shumë të larta të sigurisë rrugore.

Kështu, përveç ngritjes së kapaciteteve, këtu brenda janë edhe këto kosto, të cilat janë futur apriori.

Kostot operative që janë te pjesa e dytë, i përkasin FSHZH-së. Ato janë rreth 2 milionë euro ose rreth 3% të koston totale të kredisë.

Përsa u përket zonave të investimit...

Erion Braçe – A mund të më shpjegosh pak, se çfarë janë këto kosto?

Jorida Tabaku – Nuk u sqarova mirë, te shërbimet e konsulencës përfshihet realizimi i projekteve? Te kostot operative të FSHZH-së janë përfshirë, apo jo?

Ermir Omari – Po.

Jorida Tabaku – Janë pothuajse 3 milionë euro. Edhe supervizimi është brenda koston së konsulencës?

Ermir Omari – Po.

Jorida Tabaku – Domethënë nuk është asistencë teknike, siç thoni në fillim të projektit?

Ermir Omari – Quhet asistencë teknike.

Erion Braçe – Ashtu e kanë emërtuar.

Jorida Tabaku – E di unë si e emërtojnë, por këta e quajnë ndryshe, e quajnë ngritje kapaciteteve për të trajnuar stafin. Kështu e keni shpjeguar këtu. Apo hartohen projekte? Ndoshta duhet ta rishikojmë këtë, në qoftë se hartohen projekte, siç po thoni ju.

Ermir Omari – E nisa shpjegimin duke thënë se ai komponent i asistencës teknike, që është përmendur aty, ka edhe dy komponentë të tjerë të përfshirë. Domethënë asistencë teknike për bashkitë, ku do të bëhet investimi, ekziston. Domethënë ngritja e kapaciteteve të tyre për menaxhimin e projektit, për mënyrën e mirëmbajtjes, për integrimin, për *triggri*-n e

turizmit në zonat ku do të kalojë rruga dhe përveç këtyre komponentëve, ka edhe këta të tjerët, që janë të përfshirë në një kategori.

Jorida Tabaku – Zoti kryetar,

Kjo që thotë zotëria, që është shumë e rëndësishme dhe besoj se duhet të ishte në këtë propozim. Po shoh se nuk reflektohet fare këtu. Këtu thuhet...

Erion Braçe – Në marrëveshje apo në relacion?

Jorida Tabaku – Po i referohem relacionit.

Erion Braçe – Nuk mund t'ia kërkojmë këtij relacionin, por duhet t'ia kërkojmë qeverisë që t'i shkruajë mirë.

Jorida Tabaku – Përfaqësuesit e qeverisë janë.

Erion Braçe – Zotëria është i FSHZH-së. Zotëria që ju lavdëruat, është i qeverisë.

Jorida Tabaku – Zotëria që unë lavdërova mund ta përmirësojë në rastin tjetër, por këtu po i referohemi një dokumenti zyrtar.

Erion Braçe – Edhe këtu ka vend për përmirësim.

Jorida Tabaku – Tani, mos ta kthejmë në një shaka. Dhashë një vlerësim për një përfaqësues të qeverisë për të cilin thashë se më në fund ka njohuri profesionale. Nuk besoj se bëra gabim.

Erion Braçe - Shumë mirë bëre!

Jorida Tabaku – Unë thashë se më në fund, kemi një njeri profesional. Tani nuk besoj se bëra gabim. Hall të thuash se është i korruptuar, hall të thuash se është i mirë.

Erion Braçe – Shumë mirë bëre!

Me ndërhyrjen tënde të dytë, edhe ai ka vend për përmirësim.

Jorida Tabaku – Këtu thuhet se përfshihen ngritja e kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore, ofrimi i këshillave për të përmirësuar sistemet ekzistuese të menaxhimit të aseteve për të përmirësuar planifikimin etj. Pra, nuk flitet për projekte.

Në qoftë se është rasti, mendoj se ka vend të përmirësohet, sepse ka shumë ndryshim ofrimi i këshillave dhe trajnimi me hartimin e projekteve për rritjen e sigurisë në rrugë, siç e përmendët ju, si dhe shpenzimet operative të FSHZH-së.

Shqetësimi im është i vazhdueshëm. E kam prej 5 vjetësh në këtë komision dhe e kam pasur edhe kur kam qenë zëvendësministre e Integritetit, kur më sillnin një projekt të tillë.

Unë e kuptoj që donatorët ndoshta mund të kërkojnë asistencën teknike, por besoj se është në aftësinë e drejtuesve të qeverisë shqiptare që ta kenë këtë në një vlerë sa më të ulët. Në qoftë se kjo është për projektin, atëherë shumë mirë, ta specifikojmë dhe ta detajojmë.

Ermir Omari – Ajo është te relacioni, i shpjeguar së bashku me vlerat përkatëse për secilën nënkategori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Te relacioni e ka kërkuar zonja dhe nuk është atje.

Fjala për ju, zoti Haxhinasto!

Edmond Haxhinasto – Faleminderit!

Duke pasur parasysh edhe vërejtjet e kolegut të mëparshëm, që na drejtohet neve të LSI-së për detyrimet që kemi pasur më parë, të cilit i përgjigjem se po përpiqemi t'i bëjmë punët më mirë se në të kaluarën. Nuk ka arsye që disa punë që nuk janë bërë mirë, të mos t'i bëjmë mirë.

Dëshiroj të bëj 2 pyetje.

E para, edhe në relacion, edhe nga paraqitja që bënë përfaqësuesit e qeverisë dhe ata të FSHZH-së ka një konfuzion, kur flitet për aktet rrugore. Herë flisni për akse kryesore, herë flisni për akse rrugore. Në të dyja rastet është një term i gabuar, sepse akset rrugore nuk janë përgjegjësi e FSHZH-së, por janë përgjegjësi e ARRSH-së. Kështu, nuk është ky problemi. Problemi nuk është i terminologjisë. Unë mendoj se problemi është konceptual. Aktualisht, në Shqipëri operon ARRSH, i cili sipas statusit që ka, duhet të jetë përgjegjës për rrjetin kombëtar rrugor. Operon edhe FSHZH, i cili këto vitet e fundit ka pasur shumë më tepër mundësi financimi se ARRSH-ja. Ekzistojnë edhe bashkitë, të cilat jo vetëm që kanë marrë në mirëmbajtje një pjesë të konsiderueshme të rrjetit kombëtar, por sipas relacionit tuaj, do të kenë përgjegjësi edhe për ndërtimin e rrugëve. Prandaj, kryetar, unë mendoj se është çasti të bëhet një rivlerësim shumë serioz i mënyrës se si janë ndërtuar rrugët në Shqipëri.

Unë nuk jam më dakord të ketë një njësi, e cila merret me rrugët rurale, ndërkohë që është marrë edhe me rrugë kombëtare, por emrin e ka për rrugë rurale, ndërkohë, që janë edhe dy institucione shumë të rëndësishme, që merren me të njëjtën gjë. Për mendimin tim nuk ka zonë të Shqipërisë, që nuk duhet konsideruar e rëndësishme. Ka ardhur koha që ne të kemi një standard për ndërtimin e rrugëve.

Fatkeqësisht, standardi që është përdorur nga FSHZH-ja ka qenë shumë i ulët. Urat që shihni përgjithësisht të shembura nga reshjet e ndryshme, janë ndërtuar nga FSHZH-ja. Nuk kam parë asnjë urë të dëmtuar, të shembur gjatë përmbytjeve, të ndërtuar nga ARRSH.

Çështja parimore është se ka ardhur çasti, kur ne duhet të unifikojmë mënyrën e planifikimit, të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së rrugëve në Shqipëri.

Edhe për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, edhe për atë të menaxhimit të mbetjeve, para pak kohësh u ndërtua Agjencia Kombëtare. Prandaj t'ua lëmë këtyre agjencive, që në mënyrë të konsoliduar dhe të integruar t'i trajtojnë këto investime. Ky ishte një koment, i cili mendoj se është shumë i rëndësishëm.

Nga diskutimet e parafolësve doli edhe një problem tjetër, shumë i rëndësishëm, që është qëndrueshmëria e investimeve dhe qëndrueshmëria e sistemit. Ju flisni për qëndrueshmëri të sistemit të rrugëve, ndërkohë që merrni kredi për të realizuar veprat tuaja. Qëndrueshmëri do të thotë që të vendosësh një mekanizëm të tillë, që jo vetëm ta realizosh investimin, por edhe ta mirëmbash atë, duke ruajtur të gjithë parametrat e sigurisë dhe parametrat e tjerë për të cilët ka nevojë rruga. Edhe për këtë arsye, për dimensionin e qëndrueshmërisë...

Shoh që disa nga kolegët nuk kanë vëmendje, por nuk ka problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e kisha për ju, kryetar.

Edhe për dimensionin e qëndrueshmërisë, kolegu parafolës tha edhe faktin që ju merrni vazhdimisht kredi për t'i mirëmbajtur rrugët dhe për të realizuar punën tuaj, por qëndrueshmëri do të thotë që të gjithë rrjetin tonë të rrugëve ta vëmë në një sistem të tillë që kontributorët, burimet e brendshme të jenë të mjaftueshme për investimet dhe për mirëmbajtjen. Kështu edhe për këtë çështje, që është qëndrueshmëria e rrjetit, duhet menduar seriozisht, qoftë me rishikimin e taksave, si vilen ato, nivelin e tyre, ashtu edhe mënyrën se si gjenden burimet e tjera për investime. Kaq kisha.

Faleminderit!

Erion Braçe - Fjala për ju, për një reagim!

Ermir Omari – Desha të sqaroja, se lidhur me përzgjedhjen e rrugëve, nuk është FSHZH-ja, që ka vendosur t'i zgjedhë rrugët. Kjo bëhet sipas metodave të BB-së, në bashkëpunim me ekspertët e tyre. Për projektimin e tyre do të përdoret manuali i vitit 2015, standardi i projektimit. Kështu, të gjitha rrugët, si ato nacionale, si ato rurale do të vihen në këtë manual të miratuar nga qeveria.

Për problemin e urave, ju kujtoj urën e Drojës në rrugën Thumanë-Laç. Kjo urë nuk është ndërtuar nga FSHZH.

Faleminderit!

Përparim Spahiu - Faleminderit!

Kjo që po them, lidhet me qenien deputet i një zone. Nuk e di, nëse zoti Omari ka qenë ndonjëherë në Bulqizë. Do të ishte mirë të ishte këtu drejtori i FSHZH-së, pasi jam lutur 5 vjet për një rrugë 5 kilometra të gjatë, që lidh 6 fshatra.

A mund të dimë konkretisht diçka si deputetë, nëse ky projekt është mbarëkombëtar apo është për zona të veçanta, të cilat i vendos BB-ja? Pra, ju nuk merreni me asgjë përveçse menaxhimit të projektit. A ka ndonjë shans të bëhet ndonjë metër rrugë rurale në bashkinë e Bulqizës? Deri tani janë zero. Bëhet fjalë për dy rrugë. Është një rrugë që lidh Krastën, që është 15 kilometra, është dhe rruga e Zogjaj, që lidh 5 fshatra. Kemi ardhur te ju, e kemi ndarë me segmente dhe jemi lutur shumë, por nuk është bërë. A ka ndonjë shans bashkia e Bulqizës të përfitojë nga ky projekt?

Ermir Omari – Desha të sqaroja, se për këtë projekt është ndjekur një metodologji e tillë: u është bërë thirrje 61 njësive të qeverisjes vendore për të sjellë segmentet e tyre prioritare për investime. Është marrë një listë me rreth 140 rrugë dhe këto kanë rënë nën njësitë, e cila ka pasur si kriter turizmin, agrikulturën, numrin e popullsisë dhe trafikun në zonë.

Përparim Spahiu – Po kriter për të pasur akses të shpejtë te spitali, nuk ka?

Ermir Omari – Këto janë kriteret të vendosura, sepse ky program promovon turizmin dhe agrobiznesin.

Erjon Braçe – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Antoneta Dhima – Në vijim të fjalës së koleges Tabaku, desha të dija nga ju se cilat janë bashkitë, që do të përzgjidhen për t'u financuar nëpërmjet kësaj kredie? Apo kjo do të varet nga programi “100 fshatrat”?

Erjon Braçe – Sapo e sqaroi zotëria, që nuk ka lidhje as me programin “100 fshatrat” as me të tjerat. Zotëria u shpreh qartë, se kjo kredi ka pasur si kriter turizmin, agrikulturën, numrin e popullsisë dhe trafikun në zonë.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Para se të kalojmë në votim, zoti Pëllumbi, të përfshihen në relacion edhe sugjerimet që bëri zoti Haxhinasto për problemin e qëndrueshmërisë së rrugëve dhe natyrisht, edhe të mënyrës së financimit të ndërtimit të rrugëve në atë kontekst që ai tha.

Atëherë, hedhim në votim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Kush është dakord në parim? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi.

Faleminderit !

MBYLLET MBLEDHJA